

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5591
E martë, 2 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Endrit Shala emërohet ministër i Tregtisë dhe Industrisë

IFAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

MË 29 SHTATOR 2018, TRI ZHVILLIME HISTORIKE PËR KOSOVËN, RAJONIN DHE BOTËN! F. 11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

INFORMATA, SHOOËRIM, LOJËRA DHE MUZIKË NË DITËN E PARË TË STUDENTËVE TË RINJ NË UP F. 5

THAÇI: TRANSFORMIMI I FSK-SË ËSHTË I PANDALSHËM DHE PO BËHET ME KUJDES F. 3

EKONOMI

24 MIJË VENDE TË PUNËS KANË HUMBUR NË KOSOVË

F. 8

PULLA POSTARE ME IMAZHET E EJUP STATOVICIT DHE FEHMI AGANIT F. 8



KULTURË

MINISTRIA E KULTURËS MBËSHËTET REALIZIMIN E LIBRIT MONOGRAFIK PËR NEXHMIJE PAGARUSHËN F. 10

SPORT

PRITEN MEDALJE NË BUENOS AIRES F. 15

KOSOVA, VEÇ ME DY KLUBE NË EVROPË F. 15



FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERIM REKA IFAQE 4-5

Skenari më real për Maqedoninë, shkuarja në zgjedhje të reja

- Ndikimi rus në referendum ishte evident

Ish-ambasadori i Maqedonisë në Bruksel, njëherësh profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka bërë me dije se pas referendumit Maqedonia duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Në këtë intervistë dhënë

për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se në këto zgjedhje për herë të parë do të duhej të formohet një bllok pro euroatlantik, në të cilin do të duhej të hynin të gjitha partitë e vogla, duke përfshirë edhe ato shqiptare që tani nuk janë pjesë e koa-

licionit qeverisës. Duke komentuar rezultatit e referendumit, Reka ka treguar se evident në këtë proces ishte ndikimi rus. Sipas tij, ky ndikim do të jetë i fuqishëm edhe në anën e Beogradit në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi

Kosova kërkon nga BE-ja që të përshpejtohet liberalizimi i vizave

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, në Konferencën e 14-t të Rajoneve dhe Qyteteve të Evropës ka thënë se Bashkimi Evropian duhet ta njohë progresin e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave dhe t'i japë dritën e gjelbër lëvizjes së lirë të qytetarëve të saj. Edhe ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, e cila ishte pjesëmarrëse në këtë konferencë, ka kërkuar mbështetjen e komisionarit për zgjerim të BE-së, Johannes Hahn, që procesi i vendimarrjes për liberalizimin e vizave për Kosovën të përshpejtohet dhe përmbyllet këtë vit IFAQE 3



Ish-liderët studentorë të '97-s të bashkuar kujtojnë protestën e 1 tetorit IFAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Maqedonia pas referendumit për emrin

Kryeministri Zoran Zaev synon që çështja e emrit të kalojë në parlament përmes ndryshimeve kushtetuese, por për këtë nevojiten dy të tretat e votave të deputetëve, të cilat shumica parlamentare nuk i ka. Nëse nuk kalojnë ndryshimet kushtetuese, atëherë kryeministri maqedonas tha se vendi mund të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, në fund të muajit nëntor



Shkup, 1 tetor - Mosarritja e pragut të nevojshëm prej pesëdhjetë përlindësh të daljes së votuesve në referendumin për ndryshimin e emrit të Maqedonisë ka nxitur reagime të ndryshme në këtë vend. Qeveria nuk e quan dështim, sepse referendumi kishte karakter këshillëdhënës dhe jo detyrues. Kështu që, tani i takon parlamentit të merret me ndryshimet kushtetuese për miratimin e marrëveshjes me Greqinë për ndryshimin e emrit në Republika e Maqedonisë së Veriut. Edhe komuniteti ndërkombëtar e pret të njëjtën gjë. Ndërkaq, vëzhguesit ndërkombëtarë e cilësuan referendumin si një proces të qetë dhe të menaxhuar në mënyrë të paanshme.

Referendumi i së dielës për ndryshimin e emrit të Republikës së Maqedonisë shfaqti një shifër jashtëzakonisht të madhe të atyre që votuan për, mbi 600 mijë votues ose pak më shumë se 91 për qind të atyre hodhën votën. Por, kjo nuk mjaftoi pasi nuk u arrit pjesëmarrja e nevojshme prej 50 përqindëshit nga një milion e tetëqind mijë votuesit e regjistruar.

Kryeministri Zoran Zaev synon që çështja e emrit të kalojë në parlament përmes ndryshimeve kushtetuese, por për këtë nevojiten dy të tretat e votave të deputetëve, të cilat shumica parlamentare nuk i ka. Nëse nuk kalojnë ndryshimet kushtetuese, atëherë kryeministri maqedonas tha se vendi mund të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, në fund të muajit nëntor. "Maqedonia evropiane fitoi më shumë vota për se çdo fitues i zgjedhjeve parlamentare

në historinë e Maqedonisë së pavarur", tha Zaevi. "Marrëveshje më të mirë me Greqinë nuk ka dhe nuk mund të ketë. Anëtarësimi në NATO dhe në Bashkim Evropian nuk ka dhe nuk mund të ketë alternativë", theksoi kryeministri para përkrahësve dhe një numri të madh gazetarësh nga vende të rajonit dhe më gjerë.

Por, partneri qeveritar Bashkimi Demokratik për Integritet në këtë fazë nuk duket i interesuar për zgjedhje të reja. Kryetari i BDI-së Ali Ahmeti tha të dielën në mbledhje se deputetët janë të zgjedhur që të marrin vendime të rëndësishme, e të guximshme dhe jo për të kalkuluar për zgjedhjet e ardhshme dhe mandatin e ardhshëm. Ai tha se qytetarët e vendit ia deleguan vendimmarrjen Parlamentit të Republikës së Maqedonisë dhe deputetëve të zgjedhur në zgjedhje legjitime dhe demokratike.

Ndërkaq, kryetari i VMRO-DPMNE-së opozitare, Hristijan Mickovski duke folur në një konferencë me gazetarë, mossuksesin e referendumit e quajti "një humbje të madhe për kryeministrin Zaev dhe qeverinë e tij", ndërkohë që e porositi kryeministrin maqedonas të largohet nga posti dhe të shkojë, siç u shpreh, "në pension afatgjatë". Sipas të dhënave të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, në referendum morën pjesë 37 për qind e votuesve dhe prej tyre mbi 91 për qind kanë votuar në favor të ndryshimit të emrit.

Procesin e votimit e ndoqën 200 vëzhgues të misionit ODIHR, disa qindra përfaqësues të ambasadave dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare dhe rreth 12 mijë vëzhgues vendas.

Shefi i misionit ODIHR, Jan Petersen, vërejtji se liritë themelore u respektuan në referendumin e realizuar në mënyrë të paanshme, me gjithë disa zbrazëtirave në kornizën ligjore. Vëzhguesit thonë se regjistri zgjedhor duhet rishikuar. Ambasadori Petersen thotë se megjithatë gjatë takimeve me zyrtarët e lartë të Maqedonisë nuk është ngritur si çështje numri i dyshuar, i lartë i votuesve.

Shtefan Shenah, shef i delegacionit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës thotë se ka ndjerë mosbesim lidhur me listën e votuesve. "Tani kemi mjaft kohë dhe shpresoj që autoritetet do ta

qartësojnë dhe do të punojnë në listën e votuesve, sepse edhe njerëzit në rrugë shprehin mosbesim për regjistrin zgjedhor", u shpreh Shenah.

Komuniteti ndërkombëtar e ka përshëndetur procesin e qetë dhe vullnetin e votuesve në Maqedoni.

Shefja e Bashkimit Evropian për politikë të jashtme, Federica Mogherini dhe Komisionari për Zgjerim, Johannes Hahn, në një deklaratë të përbashkët theksojnë se shumica e atyre të cilët votuan i thanë po marrëveshjes së Prespës dhe të ardhmes së tyre evropiane. Tani parlamenti do të thërritet t'i vazhdojë hapat e mëtejshëm për zbatimin e marrëveshjes me vendimin për mira-

timin e ndryshimeve kushtetuese, thuhet në komunikatën e zyrtarëve të lartë evropianë.

Ambasadori amerikan Jess Baily përsëriti qëndrimin e ShBA-së që kishin përshëndetur rrjedhën e referendumit. "Tani hapi i ardhshëm i zbatimit të marrëveshjes së Prespës është që ajo të kalohet në parlament, ndërsa nënvizoi shpresat që drejtuesit politikë dhe ligjvënësit t'i lënë mënjatë dallimet partiake dhe të përqendrohen tek interesat më të gjera të këtij vendi. Ta zënë këtë moment historik që mund t'i sigurojë të ardhmen Maqedonisë brenda familjes së institucioneve perëndimorë", tha Baily.



Endrit Shala emërohet ministër i Tregtisë dhe Industrisë

PRISHTINË, 1 TETOR - Endrit Shala është emëruar edhe zyrtarisht ministër i Tregtisë dhe Industrisë. Shala deri më tani ka qenë këshilltar i zëvendëskryeministrit të Kosovës, Fatmir Limaj. Shala emërohet në këtë pozitë pasi që ditë më parë nga kjo pozitë është liruar Bajram Hasani. Endrit Shala me rastin e emërimit në postin e ministrit të Tregtisë dhe Industrisë ka marrë shumë urime nga bashkëpartiakët dhe miqtë e tij.



Vuçiqi sot takon Putinin, flasin edhe për Kosovën

BEOGRAD, 1 TETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, do të qëndrojë sot (e martë) në vizitë pune në Moskë, bëri të ditur kabineti i tij. Në komunikatën që transmetojnë mediet serbe, thuhet se Vuçiqi do të takohet

me presidentin e Rusisë, Vladimir Putin.

Në delegacionin e Serbisë do të jetë edhe ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić.

Vuçiqi ka thënë më herët se do të kërkojë nga Putini mbështet-

je për Serbinë në të gjitha forumet ndërkombëtare. "Do të kem takim me Putinin dhe do të bisedojmë për të gjitha çështjet e rëndësishme, natyrisht edhe për Kosovën", tha Vuçiqi.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, dhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, kanë marrë pjesë në Konferencën e 14-t të Rajoneve dhe Qyteteve të Evropës

Kosova kërkon nga BE-ja të përshpejtohet liberalizimi i vizave

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, në Konferencën e 14-t të Rajoneve dhe Qyteteve të Evropës, ka thënë se Bashkimi Evropian duhet ta njohë progresin e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave dhe t'i japë dritën e gjelbër lëvizjes së lirë të qytetarëve të saj. Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, e cila ishte pjesëmarrëse në këtë konferencë, ka kërkuar mbështetjen e komisionarit për zgjerim të BE-së, Johannes Hahn, që procesi i vendimmarrjes për liberalizimin e vizave për Kosovën të përshpejtohet dhe të përmbyllet këtë vit



deklaruar Hoxhaj në Konferencën e 14-t për Rajonet dhe Qytetet Evropiane që po mbahet në Salzburg të Austrisë. Ai ka folur edhe për raportin e Bashkimit Evropian me shtetet

e rajonit, ku ka përmendur mosnjohjen e progresit të shënuar të Shqipërisë dhe Maqedonisë nga ana e BE-së dhe se si kjo mosnjohje dhe mosshpërblimi i punës ka pasur pasoja të dukshme. "Bashkimi Evropian duhet të punojë që ta mbajë gjallë optimizmin dhe frymën evropiane në Ballkan. Mosnjohja dhe mosshpërblimi i progresit të Shqipërisë, në veçanti të Maqedonisë, ka shënuar pasoja. Rasti konkret është, siç e keni parë të gjithë, votimi i djeshëm në referendumin për Marrëveshjen e Prespës në Maqedoni", ka deklaruar zëvendëskryeministri Hoxhaj. Ai ka theksuar se anëtarësimi i shteteve të Ballkanit në BE nuk është vetëm zgjerim i unionit, por edhe konsolidim i tij meqë gjeografikisht, kulturalisht dhe historikisht Ballkani është pjesë e Evropës. Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka qenë pjesë e Konferencës së 14-t të Rajoneve dhe Qyteteve të

Evropës, me ç'rast është takuar me komisionarin për zgjerim të Bashkimit Evropian, Johannes Hahn. Ministrja ka Hoxha ka kërkuar mbështetjen e Hahnit që procesi i vendimmarrjes për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës të përshpejtohet dhe përmbyllet gjatë këtij viti. "Ne i kemi përmbyllur të gjitha kushtet nga udhërrëfyti për liberalizimin e vizave. Ne jemi duke çuar përpara Agjendën e Reformave Evropiane dhe me dinamikë të shtuar po realizojmë masat e planifikuara nga MSA-ja", ka deklaruar ministrja Hoxha. Ajo ka thënë se pas përmbylljes së kushteve përkatëse, Kosova pret që edhe vendet anëtare dhe institucionet e BE-së t'i kryejnë të gjithë hapat proceduralë dhe procesi për liberalizimin e vizave të përmbyllet pa vonesa. Ndërkohë, komisionari për zgjerim i BE-së, Johannes Hahn, ka theksuar se Kosova e ka mbështetjen e tij për procesin integruar, duke përfshirë edhe liberalizimin e vizave.

EPOKA ERE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 1 TETOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë të hënën se Bashkimi Evropian (BE) përmes vendimit në Këshillin Evropian duhet ta njohë dhe ta pranojë progresin e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave. "Me gjithë faktin se është

dashur t'i përmbushim 95 kriteret për liberalizim, në krahasim me vendet e tjera të rajonit të cilat kanë pasur rreth 45, Kosova suksesshëm ka bërë plotësimin e secilit kriter. Bashkimi Evropian duhet ta njohë dhe ta pranojë progresin e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave dhe t'i japë dritën e gjelbër lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës", ka



Thaçi: Transformimi i FSK-së është i pandalshëm dhe po bëhet me kujdes

PRISHTINË, 1 TETOR - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka takuar sot në mëngjes ambasadorët e vendeve të Quintit, shefat e ambasadave të ShBA-së, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës dhe Italisë, si dhe shefen e Zyrës së BE-së në Prishtinë, me të cilët ka biseduar për zhvillimet e fundit, me theks të veçantë në çështjet e dialogut, Interpolit, FSK-së dhe liberalizimit të vizave. Duke folur për dialogun, presidenti Thaçi ka mirëpritur përkrahjen unike të bashkësisë ndërkombëtare për dialogun dhe negociatat në mes të



Kosovës dhe Serbisë, pa paragykuar apo kushtëzuar epilogun e tyre. "E mirëpres qëndrimin tuaj unik, se dialogu është rruga e

vetme për të ecur drejt integritimit euroatlantike dhe normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Suksesi i këtij procesi varet nga uniteti politik në Kosovë, por në masë të konsiderueshme edhe nga uniteti i shteteve të Quintit", është shprehur presidenti Thaçi. Po ashtu, ai ka theksuar se Kosova është afër finalizimit të procesit të anëtarësimit në Interpol dhe ka kërkuar koordinim dhe angazhim të shtuar në këtë fazë finale të një procesi të rëndësishëm për sigurinë në Kosovë dhe më gjerë. Kurse

në çështjen e liberalizimit të vizave, presidenti Thaçi ka theksuar se është fundamentale që të mos ketë vonesa për marrjen e vendimit meritore për qytetarët e Kosovës. Ndërsa për FSK-në ka pohuar se ka filluar procesi i përgatitjes së ndryshimeve në tri ligje, që të zgjerohet mandati i FSK-së. "Transformimi i FSK-së është proces i pandalshëm, i pakthyeshëm, që po bëhet me kujdes dhe në koordinim të plotë me partnerët tanë ndërkombëtarë", ka deklaruar Thaçi.

Flet për "Epokën e re", Blerim Reka

Skenari më real për Maqedoninë, shku

- Ndikimi rus në referendum ishte evident



Ish-ambasadori i Maqedonisë në Bruksel, njëherësh profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka bërë me dije se pas referendumit Maqedonia duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se në këto zgjedhje për herë të parë do të duhej të formohet një bllok pro euroatlantik, në të cilin do të duhej të hynin të gjitha partitë e vogla, duke përfshirë edhe ato shqiptare që tani nuk janë pjesë e koalicionit qeverisës. Duke komentuar rezultatin e referendumit, Reka ka treguar se evident në këtë proces ishte ndikimi rus. Sipas tij, ky ndikim do të jetë i fuqishëm edhe në anën e Beogradit në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi

lë dy procese strategjike të cilat nuk mund t'i mbyllë aktualisht me këtë numër të vogël të deputetëve, procesin e mbylljes së kontestit për emrin me Greqinë dhe për rrjedhojë hapjen e rrugës euroatlantike, anëtarësimin në NATO dhe avancimin në procesin negociator për anëtarësim me BE-në", ka thënë Reka. Ai ka treguar edhe si do të mund të ndodhë kjo. "Bile konsideroj se nëse vjen deri të zgjedhjet e parakohshme mund të ndodhë që për të parën herë të formohet një bllok pro euroatlantik apo pro evropian jo vetëm nga koalicioni ekzistues qeverisës, por atij do t'i bashkoheshin edhe partitë më të vogla, duke i përfshirë edhe ato shqiptare që nuk janë tani në qeveri, në mënyrë që ta shtyjë përpara këtë vijë strategjike sigurt me dy të tretat e votave", është shprehur ai. Në këtë intervistë Reka ka komentuar edhe rezultatin e referendumit, duke thënë se, pavarësisht se nuk është arritur numri i kërkuar, nuk mund të injorohet fakti se 91 për qind e qytetarëve në këtë referendum kanë votuar për Maqedoninë euroatlantik. Reka ka bërë me dije se ndikimi rus në këtë referendum ishte evident, duke paralajmëruar se ky ndikim nuk duhet injoruar as në fazën

finale të dialogut Kosovë - Serbi. "Si përfundim mund të them se mosdalja e mbi gjysmës së elektoratit në referendum tregon se sa i fuqishëm ka qenë ndikimi rus dhe se sa duhet pasur kujdes në parashikimet apo përcaktimet e ardhshme strategjike për tërë rajonin. Sidomos këtë duhet të kemi parasysh në Kosovë gjatë procesit të finalizimit të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Unë llogaris se Rusia ende do të jetë shumë fuqishëm e përfshirë në anën e Serbisë në këtë proces", ka thënë Reka

"Epoka e re": Z. Reka, rezultatet e referendumit në Maqedoni për emrin e ri tregojnë se nuk është arritur censusi për dalje mbi 50 për qind. Cili është komenti juaj?
Reka: Pas 25 vjetësh betejë diplomatike për emrin e shtetit, Maqedonia prej kësaj vere ka hyrë në betejën me numra. Beteja e parë ishte me referendumin dhe e dyta është në Kuvend për ndryshimet kushtetuese. Në të parën nuk u sigurua numri i nevojshëm për censusin, kurse në betejën e dytë nevojiten 80 vota për ndryshimet kushtetuese. Mendoj se referendumi ka pasur dy porosi: e para, është procedurale-teknike dhe kjo tregon se nuk

është kaluar pragu i kërkuar që ishte mbi gjysma e elektoratit të dilnin në votime, kurse porosia e dytë është përmbajtësore e politike, ku shumica absolute e votuesve prej 91 përqindësh kanë votuar pro NATO-s dhe BE-së. Madje kjo përqindje kaq e lartë për orientimin euroatlantik të vendit është edhe shumë më e lartë se në të gjitha anketat që janë bërë vitet e fundit për të njëjtën çështje, ku përkrahja nuk e kalonte 80 përqindëshin. Me fjalë të tjera, porosia është shumë e fuqishme, se qytetarët e Maqedonisë janë pro orientimit strategjikisht euroatlantik për NATO dhe BE. Referendumi ishte vetëm një pjesë e procesit, madje mbajtja e tij nuk ishte detyrimi juridik nga marrëveshja e Prespës, sepse në nenin 1, paragrafin katër, pika V i lejonte Maqedonisë si opsion nëse ajo dëshiron të vizioj referendumin. Ndërsa detyrim obligativ-juridik nga marrëveshja e Prespës është ndryshimi i Kushtetutës ashtu siç parashihet në nenin 1, paragrafin 4, pikën G dhe D të kësaj marrëveshje.

"Epoka e re": Pritjet kanë qenë që do të arrihet censusi mbi 50 për qind. Çfarë ka ndikuar në këtë

EPOKA E RE**Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 1 TETOR - Ish-ambasadori i Maqedonisë në Bruksel, njëherësh profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka treguar për atë që do të mund të ndodhë pas referendumit në Maqedoni. Ai ka thënë se skenari më ideal është që koalicioni qeverisës ta bindë VMRO-DPMNE-në për ta votuar marrëveshjen me Greqinë në Kuvend ndonëse, sipas tij, kjo vështërsë do të ndodhë. Në këtë

intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka thënë se më e mundshme është që vendi të shkojë në zgjedhje të reja në mënyrë që koalicioni aktual ta marrë shumicën e nevojshme të mandatave për ta miratuar këtë marrëveshje. "Mendoj se skenari më real do të jetë shkuarja e vendit në zgjedhje të parakohshme deri në fund të vitit, në mënyrë që ky koalicion qeverisës pro euroatlantik ta sigurojë shumicën e mjaftueshme prej dy të tretave të votave që t'i shtyjë ndryshimet kushtetuese dhe me këtë t'i mbyl-

arja në zgjedhje të reja



oritare në të cilat nuk do të ketë kompromise: pavarësia e gjyqësorit dhe sundimi i ligjit. Prandaj, mendoj se skenari më real do të jetë shkuarja e vendit në zgjedhje të parakohshme deri në fund të vitit, në mënyrë që ky koalicion qeverisës pro euroatlantik ta sigurojë shumicën e mjaftueshme prej dy të tretave të votave që t'i shtyjë ndryshimet kushtetuese dhe me këtë t'i mbyllë dy procese strategjike të cilat nuk mund t'i mbyllë aktualisht me këtë numër të vogël të deputetëve: procesin e mbylljes së kontestit për emrin me Greqinë dhe, si rrjedhojë, hapjen e rrugës euroatlantike, anëtarësimin në NATO dhe avancimin në procesin negociator për anëtarësim me BE-në. Bile konsideroj se nëse vjen deri te zgjedhjet e parakohshme mund të ndodhë që për të parën herë të formohet një bllok pro euroatlantik apo pro evropian, jo vetëm nga koalicioni ekzistues qeverisës, por atij do t'i bashkoheshin edhe partitë më të vogla, duke i përfshirë edhe ato shqiptare që nuk janë tani në qeveri, në mënyrë që ta shtyjë përpara këtë vijë strategjike sigurt me dy të tretat e votave.

"Epoka e re": Cili ka qenë mesazhi i këtij referendumi për rajonin, konkretisht për Kosovën, e cila është në fillim të fazës finale të dialogut me Serbinë?

Reka: Porosia e parë për rajonin është përkushtimi dhe devotshmëria e 91 për qind të atyre që kanë votuar për Maqedoninë euroatlantike, dhe kjo është rrugë e pakthyeshme. Pra, 91 përqindësi nuk mund të injorohet vetëm për shkak se më shumë se gjysma e qytetarëve nuk kanë dalë në votim. Nëse në një proces elektoral siç është referendumi dalin mbi 91 për qind, pra pro NATO-s dhe BE-së, atëherë tregon se kjo shumicë nuk mund të injorohet nga faktorët e tjerë, përfshirë edhe Rusinë. Sigurisht se duhet të jemi të përgatitur për befasi të llojllojshme, sepse kjo edhe një herë tregon se pse nuk duhet nënvlerësuar rëndësinë dhe faktorin rus jo vetëm në çështjen e integritetit euroatlantik të Maqedonisë, por edhe gjatë procesit të finalizimit të normalizimit të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë. Si përfundim mund të them se mosdalja e mbi gjysmës së elektoratit në referendum tregon se sa i fuqishëm ka qenë ndikimi rus dhe se sa duhet pasur kujdes në parashikimet apo përcaktimet e ardhshme strategjike për tërë rajonin. Sidomos këtë duhet të kemi parasysh në Kosovë gjatë procesit të finalizimit të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Unë llogaris se Rusia ende do të jetë shumë fuqishëm e përfshirë në anën e Serbisë në këtë proces.

rezultat?

Reka: Konsideroj se kjo në një mënyrë është edhe pasqyrim real i elektoratit, sepse me lista të papastuara, me një numër të votuesve që vetëm figurojnë aty, por realisht jetojnë jashtë vendit, nuk mund të arrihet një prag kaq i lartë. Gjithsesi, në javët e fundit në vend u shtua edhe propaganda. Dhjetëra organizata të tubuara në platformën 'Bojkotoj', të cilat jo vetëm moralisht e politikisht, por edhe financiarisht kanë qenë të mbështetura nga një fuqi e madhe e jashtme, së cilës nuk i konvenonte anëtarësimi i Maqedonisë në NATO. Me fjalë të tjera, nëse më 28 shtator në Asambleenë e Përgjithshme të OKB-së, ministri i Jashtëm rus do të deklaronte haptas kundër anëtarësimin të Maqedonisë në NATO, më duket se çdo gjë është thënë.

"Epoka e re": Pra, ndikimi i shumëpërfolur rus në rajon në këtë referendum ka ardhur në shprehje?

Reka: Për këtë çështje unë kam shprehur brengat e mia edhe më herët. Ndikimi rus dhe ndërhyrja ruse në zgjedhjet elektorale në shtetet e fuqishme siç ishin ShBA-ja, Gjermania, Franca dhe në disa

vende të Evropës qendrore dhe lindore ishte evidente. Kjo fuqi përmes së ashtuquajturës 'luftë hibride', me shpërndarjen e lajmeve të rrejshme, pati ndikim jo të vogël edhe në Maqedoni. Mirëpo ajo që gëzon është se 91 për qind e votës pro referendumi është shifra më e lartë e atyre që kanë votuar për Maqedoninë euroatlantike.

"Epoka e re": Çfarë mund të ndodhë tash pas referendumit?

Reka: Pas këtij rezultati të referendumit unë parashikoj dy skenarë të mundshëm. Skenari i parë është ideal, që koalicioni qeverisës ta bindë VMRO-DPMNE-në t'i bashkohet votimit në Kuvend për ndryshimet kushtetuese me dy të tretat e votave. Mirëpo kjo është pak e besueshme, sepse frikësohem se VMRO-ja do të kërkonte amnisti penale për ish-liderin e saj dhe për funksionarët e tjerë të kësaj partie, të cilët janë të akuzuar për vepra penale. Kështu që, është pak e besueshme që qeveria aktuale do të bjerë në presionin e VMRO-së ngaqë në fund të fundit këtë nuk do ta lejojnë NATO-ja dhe BE-ja. Këto të fundit me fillimin e screeningut tashmë kanë përcaktuar dy fusha urgjente pri-

Informata, shoqërim, lojëra dhe muzikë në ditën e parë të studentëve të rinj në UP

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 1 TETOR - Me një aktivitet madhështor, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka hapur të hënën dyert për studentët e rinj. Në Ditën e Orientimit për Studentët e Rinj ata patën rastin që nën ritmin e muzikës dhe në shoqërimin e lojërave të takojnë stafin e fakultetit ku janë regjistruar, të njoftohen me zyrat që operojnë brenda kompleksit dhe të bëhen pjesë e shumë aktiviteteve dhe lojërave që janë organizuar për ditën e parë të tyre në universitet. I pari që iu adresua studentëve dhe të pranishmëve të tjerë në këtë ceremoni ishte rektori Marjan Dema. Ai u uroi atyre mirëseardhje të ngrohtë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", teksa u tha studentëve se, përveç studimeve në drejtimet që kanë zgjedhur, në kompleksin e universitetit do të gjejnë edhe shumë qendra dhe zyra të cilat do të kontribuojnë për zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.

Studentëve me fjalë rasti iu drejtua edhe zëvendësministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Hestet Sahiti. Ai i ka uruar studentët për fillimin e këtij rrugëtimi, duke theksuar se që arsimi i lartë ka rol thelbësor në zhvillimin ekonomik dhe social të shoqërisë. Zëvendësministri Sahiti ka

theksuar se beson se me angazhimin profesional të secilit në detyrën e vet, do të kontribuohet për arritjen e rezultateve gjithnjë e më të mira për arsimin cilësor të gjeneratave të ardhshme. Në këtë ceremoni ishte e pranishme edhe ish-presidentja Atifete Jahjaga, e cila foli para studentëve si përfaqësuese nderi e "AlumniUP". Jahjaga e konsideroi investimin në edukimin e studentëve si investimin më të mirë për vendin. Ish-presidentja Jahjaga ka thënë se, edhe pse ka qenë e diplomuar nderi në disa universitete botërore, të jesh e diplomuar e Universitetit të Prishtinës dhe të marrësh pjesë në këtë ceremoni, qenka një ndjenjë jashtëzakonisht e veçantë.

Dita e Orientimit për Studentët e Rinj u organizua nga Universiteti i Prishtinës si aktivitet pritis për 6 382 studentë që këtë vit janë regjistruar në UP. Në këtë aktivitet, i pari i këtij lloji, kanë marrë pjesë të gjitha njësitë akademike të UP-së dhe zyrat/qendrat të cilat kanë kontakt me studentët. Përveç fjalëve mirëseardhëse, aktiviteti i karakterizua me muzikë të zgjedhur nga DJ GAMBLE, performancë muzikore nga Dren Loxha, si dhe me një performancë vallëzimi nga studentët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në UP.



Pensionistët vazhdojnë të ballafaqohen me probleme të shumta

EPOKA
ERE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 1 TETOR - Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Personave të Moshuar u tha se kjo ditë ka për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimin për çështjet që prekin të moshuarit, vlerësimin e kontributit të të moshuarve në shoqërinë tonë, si dhe për ta dëshmuar respektin ndaj tyre. "Në kuadër të angazhimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, nëpërmjet Qendrës mbi Moshimin për promovimin e shëndetit dhe të mirëqenies së popullatës së moshuar, ne sot në mënyrë simbolike po e bëjmë edhe prezantimin e broshurës 'Moshimi dhe shëndeti', që konsiderojmë të jetë e dobishme për shfrytëzimin nga politikbërësit, profesionistët shëndetësorë, punëtorët socialë, aktivistët e shoqërisë civile, si dhe nga vetë të moshuarit në suaza të përpjekjeve për ta ngritur nivelin e vetëdijes dhe të shprehive për të



pasur një jetë sa më të shëndetshme", ka thënë drejtori ekzekutiv i Institutit Kombëtar, prof. Naser Ramadani. Mes të tjerash, ai ka njoftuar se nëpërmjet Institutit Kombëtar ka filluar shpërndarja e vaksinave kundër gripit sezonal në qendrat kryesore të mjekësisë familjare, njësitë e vaksinimit

dhe në të gjitha komunat e Kosovës. Ai u ka bërë thirrje grupeve më të rrezikuara siç janë të sëmurët kronikë dhe të moshuarit që t'i shfrytëzojnë vaksinat për mbrojtje kundër gripit sezonal. Zëvendësministër i Shëndetësisë, Granit Abdullahu, ka thënë se Dita Ndërkombëtare

e Personave të Moshuar duhet të shërbejë për të mundësuar dhe përhapur kontributet e të moshuarve, në familje, komunitete dhe në të gjithë shoqërinë. Sabrije Nimani nga Organizata Joqeveritare e Grave Pensioniste "Vita-Jeta" ka thënë se kjo shoqatë, e cila ka mbi 1 000 gra

anëtare të saj, ballafaqohet me probleme të mëdha për të mbijetuar me pensionin e ulët që marrin ato. Ajo u shpreh se shtimi i pagave që ishte bërë nga Qeveria para disa kohësh nuk i kishte përfshirë pensionet, e sidomos ato më të ulëtat që marrin anëtarët e kësaj kategorie.

Nimani ka paraqitur kërkesën e shoqatave dhe të Sindikatës të Pensionistëve, që në bisedimet me Serbinë të kërkohej të kthehen mjetet financiare të pensioneve të Kosovës të rrëmbyera nga Serbia, në kohën e sundimit të Millosheviqit, me të cilat do të mund të ndihmohej edhe kjo kategori shoqërore.

Hasan Berisha, sekretar i Lidhjes së Pensionistëve, ka thënë se pensionistët vazhdojnë të ballafaqohen me probleme të shumta. Ai ka thënë se një nga problemet është pensioni i ulët që ata marrin, medikamentet e shtrenjta si dhe mungesa e mjeteve financiare për t'i strehuar personat e moshuar të cilët nuk kanë familje.

Mospajtimet pozitive - opozitë bllokojnë Ligjin për RTK-në

PRISHTINË, 1 TETOR - Projektligji për Transmetuesin Publik të Kosovës (RTK) nuk ka arritur ta marrë miratimin e anëtarëve të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie për të kaluar në Kuvend. Situata u krijua pasi që opozita ka kërkuar të jepen përgjigje për vërejtjet që ka marrë ky projektligj nga Qeveria dhe institucionet përkatëse. Si pasojë e kësaj, deputetët Imet Rrahmani, Arban Abrashi dhe Valon Ramadani u larguan nga mbledhja, duke pamundësuar mbajtjen e saj për shkak të mungesës së kuorumit.

Për dallim nga opozita, deputetët e pozitës kërkuar që ky projektligj t'i procedohet sot Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që vërejtjet dhe vlerësimet për këtë ligj të jepen në seanca plenare. Imet Rrahmani ishte ai i cili kundërshtoi më së shumti që Projektligji për Transmetuesin Publik të Kosovës (RTK) të procedohet në Kuvend pa u shqyrtuar



vërejtjet drejt tij. Sipas tij, nëse ndodh kjo, atëherë do të ishte hap i ngutshëm. Kryetari i Komisionit për Administratë Publike, Nait Hasani, duke i lexuar vërejtjet që

kanë arritur në komision për këtë projektligj, ka thënë se nuk pajtohet që të themelohet edhe një kanal i veçantë televiziv për diasporën e aq më pak që ky kanal ta ketë redaksinë jashtë

Kosovës. Sipas tij, vërejtjet nga institucionet duhet të paraqiten edhe në Kuvend. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Valon Ramadani, tha se nuk e di se kujt po i ngutet që ky ligj të

kalojë në Kuvend. Për deputeten e PDK-së, Xhevahire Izmakun, ishte e panevojshme që Projektligji për transmetuesin publik të mos shkojë të hënën në Kuvend, ndonëse ajo shprehu vërejtjet e saj.

Ndërsa deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adem Mikullovi, duke i treguar disa nga vërejtjet e tij, u shpreh se ky ligj ka shumë mangësi dhe parapagimin përmes faturës së rrymës e konsideron të dështuar. Ndonëse deputetja e PSD-së, Shqipe Pantina, fillimisht u pajtua që ky ligj të procedohet për në Kuvend, pas këtij debati ajo ndërroi mendje dhe kërkoj të shqyrtohen vërejtjet e institucioneve për projektligjin për transmetuesin publik. Shkaku i mungesës së kuorumit mbledhja është shtyrë për ditën e mërkurë, ndërsa në rend dite për këtë mbledhje ishte paraparë edhe Projektligji për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Gjykata e Apelit vërteton pafajësinë e imamit Shefqet Krasniqi

PRISHTINË, 1 TETOR - Gjykata e Apelit në Prishtinë ka vërtetuar pafajësinë e Shefqet Krasniqit, ish-imam i Xhamisë së Madhe në Prishtinë. Ai është shpallur i pafajshëm nga Gjykata Themelore e

Prishtinës në muajin mars të këtij viti. "Me anë të këtij aktgjykimi Shefqet Krasniqi është liruar nga akuzat për veprat penale: shtytje për kryerjen e veprave terroriste, nxitje e urrejtjes, përçarje ose

mosdurim kombëtar, racor fetar apo etnik, si dhe për veprën penale shmangie nga tatimi", thuhet në njoftimin e Gjykatës së Apelit. I njëjti sqaron se gjykata ka konstatuar se "aktgjykimi i

atakuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale" dhe se "gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë" dhe se "nuk ka shkelje të ligjit penal".



Ish-liderët studentorë të '97-s të bashkuar kujtojnë protestën e 1 tetorit

Ish-drejtuessit e Lëvizjes Studentore të '97-s të bashkuar kanë kujtuar protestën e 1 tetorit të vitit 1997. Protagonistët e kësaj ngjarjeje, Bujar Dugolli, Albin Kurti, Muhamet Mavraj dhe Driton Lajçi, në 21-vjetorin e kësaj proteste kanë bërë homazhe së bashku te varri i ish-rektorit të UP-së, prof. Ejup Statovci. Ata kanë evokuar me mall dhe shpresë kujtimet e shkëlqimit studentor nën okupimin e errët

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 1 TETOR - Ish-liderët studentorë të vitit 1997 njëzetën vjet më vonë janë mbledhur sërisht, pa dallim partiak, për ta kujtuar protestën studentore të 1 tetorit. Protagonistët e kësaj ngjarjeje, Bujar Dugolli, Albin Kurti, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi dhe të tjerët, në 21-vjetorin e kësaj proteste, të hënë kanë bërë homazhe së bashku te varri i ish-rektorit të UP-së, prof. Ejup Statovci. Me këtë rast, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se me Bujarin, prof. Gecën, Dritonin, Muhametin, Milotin, Mihanen, Jetonin, Ilirin, Xhelalin, Lulëzonin, Mentorin dhe Fatbanin kanë evokuar me mall dhe shpresë kujtimet e shkëlqimit studentor nën okupimin e errët. "Njëzet e një vjet më vonë u mbledhëm sërisht, pa dallim partiak, për ta kujtuar protestën studentore e paqësore të 1 tetorit 1997. Bëmë homazhe te varri i ish-rektorit të UP-së, prof. Ejup Statovci, akademikut të rezistencës, juristit të qëndrues, drejtuesit të universitetit të vetorganizuar shqiptar, në kohët e ashpër të apartheidit, intelektualit që na priu në protestat e 1997-s. 'Merrni frymë sikur ne!' dhe 'Universiteti-Kosova-Studentët sot, nesër vonë!' ishin në mesin e 33 parullave tona që atëbotë e

ringritën popullin dhe e ridefinuan politikën. Me Bujarin, prof. Gecën, Dritonin, Muhametin, Milotin, Mihanen, Jetonin, Ilirin, Xhelalin, Lulëzonin, Mentorin dhe Fatbanin evokuam me mall dhe shpresë kujtimet e shkëlqimit studentor nën okupimin e errët", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Protesta e 1 tetorit e vitit 1997 është përkujtuar edhe nga liderët shtetërorë të Kosovës, të cilët kanë vlerësuar se kjo protestë i ka paraprirë luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se demonstrata paqësore e studentëve të Universitetit të Prishtinës, me mbështetje masive, i ka dhënë dinamikë të re zhvillimeve politike në Kosovë. Sipas tij, falë përpjekjeve të shumë gjeneratave Kosova ka arritur lirinë dhe pavarësinë. "Sot janë bërë 21 vjet, por ende i kemi të freskëta kujtimet nga demonstrata e 1 tetorit 1997. Ishin ditë kur studentët dhe të rinjtë tanë nuk e duronin më dhunën dhe nëpërkëmbjen e përditshme të policisë serbe, si dhe shtypjen e çdo të drejte politike dhe kombëtare nga regjimi serb. Demonstrata paqësore e studentëve të Universitetit të Prishtinës, me mbështetje masive, i dha dinamikë të re zhvillimeve politike në Kosovë. Shumë të rinj dhe të reja nga Universiteti i Prishtinës më pas iu bashkuar



radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Falë përpjekjeve të shumë gjeneratave, Kosova arriti objektivat historike: çlirim, lirinë dhe pavarësinë!", ka shkruar presidenti Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se më 1 tetor të vitit 1997 u bë kthesa e madhe me protestën masive të rinisë studentore dhe profesorëve universitarë. Ai ka vlerësuar se 21 vjet më parë rinia e guximshme është ngritur mbi padrejtësitë dhe për ta paralizuar ndryshimin e madh, luftën çlirimtare. "Popullit tonë në përpjekjet për liri asnjëherë nuk i janë shuar shpresat. Më 1 tetor 1997 u bë kthesa e madhe me protestën masive të rinisë studentore dhe profesorëve universitarë. Kujtojmë sot me krenari guximin

e kësaj rinie, për t'u ngritur mbi padrejtësitë dhe për ta paralizuar ndryshimin e madh, luftën çlirimtare. Për të ditur kah po shkojmë duhet të dimë nga erdhëmi deri këtu! Le të jetë dita e 1 tetorit përkujtuessë e rrugës që kaluam së bashku. Njëherësh, të gjithë studentëve dhe profesorëve, urime dhe shumë fat për fillimin e vitit të ri akademik! U priftë e mbara", ka shkruar Haradinaj në profilin e tij në "Facebook".

Po ashtu, zëvendëskryeministri dhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka përkujtuar protestat e vitit 1997, duke thënë se 21 vjet pas këto protesta mbesin burim frymëzimi për gjeneratat e mëvonshme. Ai ka theksuar se këto protesta i paraprinë luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sipas Limajt, protes-


tat e 1 tetorit të '97-s janë dëshmi se çfarë sakrifice është bërë për liri. "Sot kujtojmë me krenari protestat e 1 tetorit të vitit 1997 ku qindra mijëra studentë të Universitetit të Prishtinës dhe profesorë universitarë protestuan rrugëve të Prishtinës duke përçarur mesazhin se shqiptarët nuk do të duronin më shkeljen e lirive dhe të drejtave themelore që u bëheshin nga regjimi serb. Protestat e 1 tetorit të vitit 1997 i paraprinë luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. 21 vjet më pas këto protesta mbesin burim frymëzimi për gjeneratat e mëvonshme. Protestat e 1 tetorit janë dëshmi se çfarë sakrifice është bërë për liri dhe se çlirimi i Kosovës është arritur me mundin dhe përpjekjet e shumë brezave!", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

MPB-ja shënon muajin botëror të sigurisë kibernetike

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Nga dita e hënë, në kuadër të muajit botëror të sigurisë kibernetike, Ministria e Punëve të Brendshme planifikon zhvillimin e disa aktiviteteve për përmirësimin e situatës së sigurisë kibernetike në vend. Sipas një njoftimi të MPB-së, ngritja e sigurisë është e domosdoshme në të gjitha institucionet publike, duke vlerësuar rëndësinë që ka siguria kibernetike dhe sipas nevojave janë hartuar plane konkrete të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe teknologjike. "Në Kosovë përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)

është zgjeruar me shpejtësi prej vitit 2000, ndërsa tanimë TIK-u luan rol të rëndësishëm në të gjitha aspektet e jetës sonë. Përdorimi i Internetit në Kosovë është 76.6 për qind, shkallë kjo shumë e ngjashme me mesataren e Bashkimit Evropian (BE), derisa edhe sjelljet e qytetarëve të Kosovës në Internet duket të jenë të ngjashme me trendet globale", është thënë në njoftimin e MPB-së.

Në kuadër të aktiviteteve të parapara për shënimin e këtij muaji, Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me ICITAP do të



trajnojnë mbi 200 zyrtarë të ministrisë dhe agjencive të saj, të cilët

kanë qasje në domenin shtetëror për rëndësinë e sigurisë kiber-

netike.

Në kuadër të këtij muaji do të mbahen aktivitete dhe takime të ndryshme me qëllim të vetëdijësimin për rëndësinë e sigurisë kibernetike. Me inicim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qeveria e Kosovës ka miratuar koncept-dokumentin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, koncept-dokument që kontribuon për forcimin e mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, i parapara në strategjinë shtetërore për sigurinë kibernetike dhe planin e veprimit 2016-2019.

Pulla postare me imazhet e Ejup Statovcit dhe Fehmi Aganit

Në kuadër të tematikës "Personalitete të shquara", Posta e Kosovës ka emetuar të hënën dy pulla postare me imazhet e profesorëve dhe veprimtarëve Ejup Statovci dhe Fehmi Agani. Kryeshefi ekzekutiv i Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, tha se është krenari për Postën e Kosovës dhe të gjithë punonjësit e saj, që nëpërmjet emetimit të këtyre dy pullave postare t'i nderojë këta dy akademikë dhe veprimtarë të shquar të çështjes kombëtare

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

Prishtinë, 1 tetor - Në kuadër të tematikës "Personalitete të shquara", Posta e Kosovës ka emetuar të hënën dy pulla postare me imazhet e profesorëve dhe veprimtarëve Ejup Statovci dhe Fehmi Agani. Me këtë rast, kryeshefi ekzekutiv i Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, ka pritur në takim anëtarë të familjeve Statovci dhe Agani, të cilëve u ka

dhuruar pullat e para postare si dhe nga një pullë postare të punuar në bronz. Kryeshefi Hoxha ka thënë se është krenari për Postën e Kosovës dhe të gjithë punonjësit e saj, që përmes emetimit të këtyre dy pullave postare t'i nderojë këta dy akademikë dhe veprimtarë të shquar të çështjes kombëtare.

Prof. dr. Ejup Statovci ishte rektor i Universitetit të Prishtinës në

kohët më të vështira të ekzistencës së këtij tempulli të dijes, në vitet e '90-ta, gjatë kohës së okupimit të egër serb. Ai nuk u nda asnjëherë nga studentët. Bashkë me ta doli në ballë të protestës historike të 1 tetorit në vitin 1997, që shënon një kthesë të madhe në rezistencën e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Profesor Ejup Statovci ndërroi jetë më 19 tetor 1999. Për kontributin

e tij të jashtëzakonshëm rektori Ejup Statovci është shpallur hero i Kosovës nga presidenti i Kosovës më 25 maj 2018.

Prof dr. Fehmi Agani ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e Kosovës.

Si profesor universiteti ai dha një kontribut të madh edhe për ndërtimin dhe zhvillimin e Universitetit të Prishtinës. Fehmi Agani ishte një nga veprimtarët

më të dalluar politik të viteve '90. Ishte një nga ideologët më të shquar të rezistencës paqësore kundër regjimit serb. Agani mori pjesë edhe në Konferencën e Rambujesë. Profesor Agani u vra nga forcat kriminale serbe gjatë kohës së luftës në Kosovë, në pranverën e vitit 1999. Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm shpallet Hero i Kosovës nga presidenti i Kosovës, më 6 maj 2004.

Kosova dhe Bavaria me forum të përbashkët ekonomik

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, po qëndron në Bavari, me ç'rast ka zhvilluar një takim pune me ministrin shtetëror të Bavarisë për Çështje Federale, Florian Herrmann. Në këtë takim Hoxhaj ka deklaruar se është diskutuar për liberalizimin e vizave për Kosovën dhe rolin që ka luajtur Gjermania në këtë proces, për njohjen e patentshoferëve të Kosovës në Bavari, si dhe për bashkëpunimin në fushën e arsimit.

Hoxhaj ka njoftuar se me ministrin Herrmann janë pajtuar që shumë shpejt ta organizojnë një forum ekonomik të përbashkët, në mënyrë që t'i

jepet një shtytje rritjes së shkëmbimit ekonomik dhe tregtar në mes të Kosovës dhe Bavarisë. "Takim i hershëm sot në Bavari, me ministrin shtetëror të Bavarisë për Çështje Federale, dr. Florian Herrmann. Gjatë takimit kemi diskutuar për liberalizimin e vizave dhe rolin e Gjermanisë në këtë proces, për njohjen e patentshoferëve të Kosovës në Bavari, si dhe për bashkëpunimin arsimor. Po ashtu, jemi pajtuar për organizimin e një forumi ekonomik në mes të Kosovës dhe Bavarisë, për ta rritur shkëmbimin ekonomik-tregtar mes nesh", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".



24 mijë vende të punës kanë humbur në Kosovë

Që nga tremujori i tretë i vitit 2017 deri më tash kanë humbur 24 100 vende të punës. Kështu ka thënë kreu i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi. Ai ka shtuar se konkurrenca jolojale, mungesa e mjeteve financiare dhe ekonomia informale janë disa prej barrierave kryesore të të bërit biznes


EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 TETOR - Në Odën Ekonomike të Kosovës (OEK) të hënën është bërë prezantimi i IFO Indikatorit nga Oda Ekonomike i cili ka matur klimën e të bërit biznes në tremujorin e dytë të vitit 2018. Sipas këtij raporti, tremujori i dytë i këtij viti e gjeti në gjendje jo të kënaqshme të bërit biznes në Kosovë.

Kryetari i Odës Ekonomike, Berat Rukiqi, ka thënë se bizneset janë përkeqësuar në tremujorin e dytë të këtij viti. "Në çdo indikator kemi ulje të kënaqshmërisë, do të thotë kemi përkeqësim të gjendjes së bizneseve. Vetëm 26 për qind e bizneseve kanë pritje për punësim dhe kjo shënon rënie

nga tremujori i kaluar. Nga 69 për qind kemi 35 për qind të cilët janë me pritje pozitive ose që kanë pritje më optimiste për këtë tremujor. Që nga tremujori i tretë i 2017-s deri tash 24 mijë 100 vende të punës kanë humbur. Një supozim mund të jenë edhe kontratat që po bëhen jashtë vendit", ka thënë Rukiqi, duke shtuar se konkurrenca jolojale, mungesa e mjeteve financiare dhe ekonomia informale janë disa prej barrierave kryesore të të bërit biznes. Në këtë konferencë Rukiqi ka folur edhe rreth shtimit të grabitjeve dhe vjedhjeve në biznese dhe zhvillimet e tjera ekonomike në vend. "Kemi ngritur shqetësimin në polici, që nga 15 gushti kanë ndodhur shtatë grabitje dhe kjo është për t'u shqetë-



suar sepse bankat mbajnë edhe kapital të huaj. Një nga aspektet kryesore që duhet t'i nxisë investimet e huaja është siguria. Ne do t'i shkruajmë drejtorit të

përgjithshëm të policisë dhe institucioneve përkatëse. Çdo cenim i kapitalit në Kosovë lidhet edhe me procese të mëdha siç është liberalizimi. Kosova nuk e

ka imazhin e mirë, mirëpo nëse vazhdon me këtë trend, do të rezultojë me tërheqje të investimeve", është shprehur më tutje Rukiqi.

Klubi i Prodhuesve të Kosovës përkrah ndërtimin e shtëpisë Kabashi në Suharekë



SUHAREKË, 1 TETOR (ER) - Anëtarët e Klubit të Prodhuesve të Kosovës kanë vënë gurthemelin e ndërtimit të shtëpisë për familjen Kabashi në Shirokë, në Komunën e Suharekës, e cila u bë e mundur pas aksionit për ndihmë pas vërshimeve të fundit në këtë komunë. Pas thirrjes së kryetarit të Qendrës së Bizneseve të Therandës, Shaqir Palushi, për ndihmë familjeve të dëmtuara nga vërshimet, anëtarët e Klubit të Prodhuesve të Kosovës i janë përgjigjur pozitivisht këtij apeli. Pas vënies së gurthemelit, kryetari i Klubit të Prodhuesve,

Blerim Devolli, i ka falënderuar të gjithë anëtarët për këtë donacion dhe ka shprehur gatishmërinë të mbështesë edhe familje të tjera në nevojë. "Klubi i Prodhuesve ka mision fuqizimin e ekonomisë vendore, në të njëjtën kohë fokus i Klubit është edhe edukimi dhe përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve të vet", ka thënë ai. Ndërsa Shaqir Palushi ka thënë se është i kënaqur me mobilizimin e anëtarëve të Klubit ndaj këtij apeli për ndihmë. "Ky mobilizim duhet të jetë shembull që edhe prodhuesit e tjerë duhet të jenë të gatshëm t'u dalin në ndih-

më atyre që kanë nevojë", ka thënë Palushi.

Kurse Astrit Panxha, drejtor ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, ka thënë se vlerat kryesore të Klubit të Prodhuesve janë për përmirësimin e gjendjes së prodhuesve të Kosovës, për përmirësimin e kushteve të të bërit biznes, rritjes së vlerës së produkteve të Kosovës, gjithsesi edhe ngritjes së standardit të jetesës për qytetarët e këtij vendi. Gjithashtu, anëtarët e Klubit të Prodhuesve gjatë kësaj vizite në Suharekë u pritën nga kryetari i kësaj komune, Bali Muharremaj.

Aeroporti i ri i Stambollit, një mrekulli botërore

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Me një hapësirë prej 76 milionë metra katrorë dhe me një investim mbi 10.25 miliardë euro, në Ditën e Republikës së Turqisë, 29 tetor 2018, do të hapet Aeroporti i ri i Stambollit që do të jetë rreth 25 minuta larg nga qendra e qytetit. Sipas IGA-s, kompania që është përgjegjëse për operimin e aeroportit për 25 vjetët e ardhshëm, projekti do të përfundojë në katër faza. Në fazën e parë do të hapet me tri pista dhe një terminal që mund të strehojë deri në 90 milionë pasagjerë në vit. Kështu është bërë me dije në

konferencën "Turkish Airlines Corporate Club" që u mbajt në Stamboll më 17-18 shtator 2018, në partneritet me Global Business Travel Association (GBTA), në të cilën morën pjesë mbi 900 pjesëmarrës nga 71 vende të rrjetit ndërkombëtar të fluturimit që operon "Turkish Airlines". Shefi ekzekutiv i Aeroportit të ri të Stambollit, Kadri Samsunlu, ka deklaruar se pasi të përfundojë ndërtimi i plotë, pritet të bëhet aeroporti më i madh në botë. "Me 29 tetor në Ditën e Republikës së Turqisë, Aeroporti i

ri i Stambollit do të jetë në dispozicion me fazën e parë. Pasi të përfundojnë të gjitha fazat, ky aeroport do të jetë më i më i madhi në botë, me një kapacitet vjetor deri në 200 milionë udhëtarë në më shumë se 300 destinacione", ka thënë Samsunlu. Ai ka shtuar se Aeroporti i ri i Stambollit do ta bëjë integrimin e Turqisë në ekonominë botërore. "Aeroporti i ri i Stambollit do të jetë epiqendra e integritimit të Turqisë në ekonominë botërore, duke i shtuar vlerë ekonomisë, në veçanti turizmit", ka deklaruar Samsunlu.



UShAF-ja bëhet me laborator të arkitekturës, dizajnit dhe teknologjisë së drurit

FERIZAJ, 1 TETOR - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) ka hapur dyert të hënën për t'i prititur me një ceremoni solemne studentët në vitin e ri akademik 2018/19, në veçanti ata të cilët për herë të parë vijnë në universitet, si dhe ka bërë hapjen e laboratorit të arkitekturës, dizajnit dhe teknologjisë së drurit. Me këtë rast, rektori i UShAF, prof. dr. Agron Bajraktari, u ka dëshiruar mirëseardhje në universitet studentëve, e sidomos atyre që për herë të parë fituan statusin e studentit. "Sot universiteti ynë ka disa arsye për të festuar. Jemi pajisur me laboratorin

e arkitekturës, i cili është modern dhe i teknologjisë së fundit, i cili na vjen si donacion nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Po këtë vit stafi akademik është rritur në masë të madhe gjë që garanton rritjen e suksesit dhe cilësisë. Ndërsa ju studentë të dashur jeni me fat që jeni pjesë e UShAF-it, sepse do të studioni në kushte më të favorshme. Do të dilni nga ky universitet si profesionistë të vërtetë dhe do ta ndihmoni zhvillimin e tregut kosovar. Pajisjet e arritura do të ndikojnë te studentët dhe do t'i bëjnë ata konkurrentë në treg", ka thënë rektori Bajraktari.



Sindikata e Punëtorëve e Komunës së Mitrovicës kërkon korrigjimin e Ligjit të ri të pagave



MITROVICË, 1 TETOR (ER) - Të hënën është mbajtur protesta e paralajmëruar ditë më parë nga drejtuesit e Sindikatës së Punëtorëve të Komunës së Mitrovicës. Qëllimi i kësaj proteste ishte kundërshtimi i Projektligjit për pagat, pasi shërbyesit civilë të nivelit lokal janë të diskriminuar në krahasim me ata të nivelit qendror. Me këtë rast punëtorët në fjalë kanë kërkuar nëpërmjet kësaj proteste nga Komisioni për Administratë Publike si dhe nga Kuvendi i Kosovës që në Projektligjin nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik të bëjnë sa më parë ngritjen e Koeficientit për shërbyesit civilë të komunave. Ata thanë se sindikata duhet të jetë më aktive lidhur me të gjitha çështjet që u

përkasin shërbyesve civilë në nivel lokal.

Gjatë kësaj proteste fjalën e mori kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Komunës së Mitrovicës, Mehmet Bajrami, i cili shprehu pakënaqësitë e punëtorëve të komunës lidhur me ligjin e ri për paga i cili po diskriminon punëtorët e nivelit lokal krahasuar me ata të nivelit qendror. Po ashtu, Mehmet Bajrami, kryetar i Sindikatës, ka thënë se kohë më parë u janë drejtuar edhe Ministrisë së Administratës Publike, ku i kanë paraqitur pakënaqësitë e tyre për paga, mirëpo deri më tani asgjë nuk kanë ndërmarrë. "Punonjësit e komunës janë më të diskriminuarit deri më tani prej të gjithë

shërbyesve të tjerë të Kosovës. Ata sa më parë duhet të kategorizohen në bazë të arsimimit dhe kualifikimeve të tjera, ndërsa rritja e pagave duhet të bëhet në mënyrë lineare e të mos ketë kaq dallime të mëdha. Nëpërmjet kësaj proteste kërkojmë që sa më parë të bëhet korrigjimi i Ligjit të ri të pagave", ka thënë Bajrami.

Gjatë një takimi të realizuar në mes të kryetarit të Sindikatës së Punëtorëve të Komunës së Mitrovicës, Mehmet Bajrami, dhe homologut të tij nga Vushtrria, Ramadan Kutllovci, u tha se Komuna e Vushtrrisë shumë shpejt do të dalë me një qëndrim dhe me një protestë të tillë, por presin t'u bashkëngjiten edhe komunat e tjera të Kosovës.

Zyrtarët komunalë në Rahovec inspektojnë punimet në disa projekte infrastrukturore

RAHOVEC, 1 TETOR (ER) - Komuna e Rahovecit është duke vazhduar realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me infrastrukturë rrugore. Ecurinë e punimeve në disa projekte e ka inspektuar Përparim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Berat Duraku, drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Drejtori i DShP-së, Përparim Krasniqi, ka inspektuar punimet të cilat janë duke u bërë në matjen dhe ngjeshmërisë në rrugën dhe trotuarin që lidh fshatrat Krushë e Madhe - Randobravë. "Këto punime janë duke u bërë në përputhje të kontratës së nënshkruar me operatorin ekonomik. Po ashtu, kam përcjell edhe punimet

të cilat janë duke u bërë në ndërtimin e rrugës me kubëza betoni në fshatin Malësi e Vogël", ka deklaruar ai.

Krasniqi ka shtuar se do të ketë në vazhdimësi investime nga buxheti i komunës për realizimin e projekteve që kanë për qëllim lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve nëpër të gjitha vendbanimet e komunës.



Rregullohen gjashtë rrugë në Malishevë

MALISHEVË, 1 TETOR (ER) - Në kuadër të realizimit të investimeve kapitale dhe në kuadër të realizimit të ndërtimit dhe rregullimit të infrastrukturës rrugore, nëpërmjet vendbanimet e Komunës së Malishevës, në fshatin Senik, ka filluar rregullimi i gjashtë rrugëve brenda fshatit, ku pesë prej tyre do të

asfaltohen dhe njëra do të shtrohet me rërë.

Punimet për rregullimin e këtyre rrugëve në Senik i kanë parë nga afër, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori komunal i Urbanizimit, Islam Vrenezi, të cilët janë njoftuar me ecurinë e punimeve, ndërsa

janë takuar edhe me disa prej banorëve të cilët janë shprehur të kënaqur me rregullimin e rrugëve në fshatin e tyre. Nënkryetari Berisha ka thënë se është ndarë i kënaqur me ecurinë dhe kualitetin e punimeve deri më tani, ku operatori është duke i përgatitur rrugët për asfaltimin e tyre. Ai ka bërë me


dije se këto rrugë janë pjesë e planifikimeve komunale dhe kanë qenë kërkesa të banorëve të fshatit Senik.

Drejtori i urbanizimit, Islam Vrenezi, ka njoftuar se janë duke u shtruar gjashtë rrugë në këtë fshat, ku pesë prej tyre do të asfaltohen, ndërsa një rrugë tjetër do të shtrohet vetëm me



rërë, por që do të jetë më lehtë e qarkullueshme. Sipas tij, rregullimi i këtyre rrugëve mundësohet nga buxheti komunal i Malishevës.

Më 29 shtator 2018, tri zhvillime historike për Kosovën, rajonin dhe botën!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Maskarada në OKB-së, me striptizet Pacolli në krye: Delegacioni nga Kosova në Kombe të Bashkuara kishte 41 veta në përbërje aq sa nuk ishin të pranishëm as në ditën kur u themelua Organizata e Kombeve të Bashkuara. Po duket se për botën ishte me rëndësi të veçantë delegacioni nga Kosova, në këtë përbërje dhe në këtë numër. Dhe se ky takim në KB nuk kishte mundësi të mbahej pa delegacionin nga Kosova andaj, për hir të sigurisë dhe paqes globale, janë të papërfillshme shpenzimet e këtij delegacioni sepse, paramendoheni se si do të zhvilloheshin ngjarjet pa formacionin nga Kosova! Realisht, presidenti i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia Vezulluese e tij, Lartmadhëria e vet, zotëri Hashim Thaçi i Parë, që herët pati angazhuar mesitë, duke paguar një mesitëri të lartë për t'u takuar me Donald Trampin, por se u takua me një Donald tjetër, me Donald Task të BE-së, i cili e "qortoi" për afërsi me bombën nga Kroacia e quajtur Kolinda. Me Donald Trumpin u fotografua për kujtim dhe biografi, pa e ndërruar një fjalë të vetme. Hashimi u takua edhe me Johanes Hanin që po e përkrahë për "korrigjim" të kufijve sikur edhe me kongresmenin Eliot Engel të cilin nuk po e lënë të qetë as në ditët si pensionist. Realisht, Hashim Thaçi, presidenti ynë legjendar, në planin diplomatik pësoi fatin e Titanikut, nuk bëri asgjë dhe nuk e realizoi asnjë takim që do të mbahej mend. Po ta dija se Hashimi do të kënaqej vetëm me një fotografi me presidentin Tramp do ta lusja Kastriotin, fqinj tim, t'ia mundësoi një kënaqësi të tillë, pa pasur nevojë të bëjë shpenzime të panevojshme aq më parë që kohë më parë Kastrioti, nga Uashingtoni ma pati dërguar një foto me Donald Trampin, ku Kastrioti dukej shumë zanzi krahasuar edhe me Trampin dhe me Hashimin. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në këtë kontekst ishte shumë më i suksesshëm sepse pati takime me njerëz shumë të afërt me presidentin Tramp dhe se nga këto takime pati premtime dhe mbështetje konkrete si për transformimin e FSK-së në forcë mbrojtëse, po ashtu edhe për mosndryshim të kufijve. Uroj të jetë kështu. Kryeministri

Haradinaj këto vizita i kaloi pa trauma të mëdha dhe pa pasur nevojë për një pompozitet. Realisht, edhe Ramushi u takua me do kujdestarë me të cilët takohen gjithmonë dhe çdo kund liderët kosovarë kur në takime të rëndësishme ndërkombëtare mbesin të vetmuar.

Po del se "ylli" i kësaj vizite me rëndësi globale ishte Behgjet Pacolli i cili e dorëzoi një raport se paska realizuar mbi 50 takime brenda ndërtesës së OKB-së dhe nga kjo del se ishin dy takime jashtëzakonisht të rëndësishme, ai me presidentin Tramp të cilit Begja, pavarësisht prej traditës fisnike shqiptare, i zuri pritën dhe vetëm mungoi edhe ndërkëmbëza e që ta detyrojë Trampin të ndalet para Begjes, t'ia shtrijë dorën "burrërisht" dhe t'ia bëjë me dije se, jo që nuk e ka harruar, por se për të mendon më shumë se për Melaninë. Pastaj, ishte takimi antologjik me zonjën e "kompletuar" dhe të "nderuar" në Kosovë, duket se Pacolli e ka identifikuar Kosovën me veten e tij, kryeministren e Serbisë, Ana Bernabiq, e cila e bëri Begjen gaz të botës duke luajtur lojë... me të, kurse Begja, me një dinjitet as të përmasave minimale, jargitej para saj. Realisht, edhe me kryeministrin e Marokut pati një komunikim skandaloz i cili nuk do t'i falej as të ndjerit Sahit Fyellit që bënte muzikë udhëkryqeve të Prishtinës. Prej këtyre 50 takimeve, besoj se Begja i ka llogaritur nja 35 hyrje-dalje në WC-të e Kombeve të Bashkuara, ku është pshurur light, pas infeksioneve akute të prostatës. Po të ishte një situatë normale, Begja as në ëndërr nuk do të bëhej ministër për Punë të Jashtme ose, pas skandaleve në KB, edhe sa të ishte në WC do të duhej të shkarkohej duke mos ia paguar as biletën e kthimit në Kosovë. Kështu, po na tregon përralla duke na teshur prapancën se ka shpenzuar kohë, mund dhe mjete vetjake për ta bindur një superfuqi botërore si Burkina Faso që të mos e kthejë mbrapsht njohjen e Kosovës në vend se ta kryejë punën për çka po keqpërdor mjete të buxhetit të Kosovës, sigurimin e sa më shumë njohjeve e që nuk e ka siguruar asnjë deri më tani. Përveç se ka siguruar mundësi të tjera biznesi për veten dhe kompanitë që i ka, mbi tokë dhe nëntokë! Uroj që këtë kërcënim ndaj Begjes të mos e lexojë prokuroi Rexhë se më çon në fllad sikur Milaimin dhe Shkumbinin. Apo, sigurisht më bën dyshe me Goran Rakiqin, pasi ai e pati një kërcënim bukur të fortë ndaj Hashimit, Abelardit, Shpendit, Rashitit dhe Bedri Hamzës që e kaluan fundjavën në detin (për Kosovën) të Ujman Gazivodës. Se Begja po e shkarkon

testosteronin mbi ne impotentët, disi kuptohet, sepse ashtu bëhet biban politik. Po se një djalë i një njeriu që ka kontribuar shumë për lirinë e Kosovës e që tani është në shërbim të striptizetës politike Beg-rie Kurcolli duke ia mbuluar, me shumë shkathësi mbrapshtitë që i bënë! Ndal pak o Jetlir dhe kujtoje sa shumë mund dhe sakrificë na ka kushtuar që të të quhesh Jetlir! Ose, vazhdoje kështu, deri në theqafje!

Tri zhvillime dhe takime historike dhe potencialisht dramatike:

Takimi apo zhvillimi i parë: Lëvizja Vetëvendosje më 29 shtator 2018 organizoi një protestë krejtësisht paqësore për ta kundërshtuar Hashim Thaçin si kryenegociator, kryegjeodet dhe kryeshef i kadas-trës për kufij të Kosovës. Ishte kjo shpatë me dy tehe, aq më parë që LV-ja ishte e vetmuar në këto protesta sa i përket organizimit, përjashtuar këtu deputeten Vjosa Osmani që ishte në protestë dhe deputetin Korab Sejdiu që ishte, gjithashtu, në protestë. "Hasan Prishtina" i Mitrovicës, Agim Bahtiri, nuk dukej se ishte aty sikur edhe urryesi i madh i UÇK-së, mjeku "humanist" dhe deputet i partisë me së paku 10 kryetarë, Haxhi Avdyli, nuk u duk fare, në të kundërtën Albin Kurti do t'i përshëndeste me shumë respekt dhe dashuri siç bëri me Vjosën dhe Korabin. Protestat ishin shembullore, në çdo aspekt. Paqësore, si nga ana e protestuesve, po ashtu edhe të policisë që bashkëpunuan shumë mirë. Edhe kërkesat ishin të arsyeshme dhe të drejta dhe pa folklorizëm dhe populizëm sikur që ndodhte më parë. Organizimi ishte shumë i mirë. Realisht kishte rrezik se do të dilte një numër i vogël i protestuesve meqë LV-ja shkonte e vetmuar, mirëpo ishte një vlerësim i drejtë dhe i saktë sepse ishte një kohë dhe çast shumë i përshtatshëm për protesta, për shkak të veprimeve donk-isheske të Hashim Thaçit dhe patericave që e shoqëronin. E dini që, edhe para protestës LV-ja u sulmua se është kundër shtetësisë së Kosovës, kurse Eugjeni shumë Piccola e sulmoi Albinin si të pafytyrë, duke listuar arsytet që ndikojnë drejtpërdrejt në pafytyrësinë e Albinin. Ai që ia ka shkruar atë diagnozë të pafytyrësisë për Albinin zonjës Eugjeni shumë Piccola, dëmin më të madh ia ka bërë pikërisht Eugjenisë dhe jo Albinin. Po e përfundoj me kaq për këtë diversion të moralit, përballë imoralitetit! Në bazë të përvojës "shekullore" në këtë fushë vlerësoj se në protestë ishin midis 35-40 000 qytetarë, por se më së paku kishte protestues nga Prishtina. LV-ja nuk duhet të distancohet nga ata që duan të protestojnë siç ishte rasti me ata që u ndanë nga

LV-ja dhe e formuan apo ringjallën PSD-në e Kaçusha Jasharit. Dhe LV-ja duhet ta ketë të qartë se nuk ishin të gjithë protestuesit anëtarë të LV-së. Kjo protestë nuk e krijon asnjë ndryshim nëse nuk formohet një masë kritike që do të ishte në gjendje të bënte presion të përditshëm apo, së paku, të përjavshëm, duke ruajtur apo edhe duke rritur numrin e protestuesve. Nëse në çdo dy muaj bëhen protesta të tilla atëherë, si përgjigje, do ta kenë ekskursionin e Thaçit në Ujman, gjatë protestës tjetër ndoshta në Brezovicë, kurse atë të radhës në Kopaonik por, pa e rrezikuar fare Hashimin e Madh dhe hashimët e vegjël. Kjo protestë kishte publicitet dhe mbulim të madh medial, sikur atij vendor ashtu dhe atij ndërkombëtar. Dikush e konsideron si mangësi dhe mashtrim se protesta u bë në mbrojtje të Republikës, duke injoruar simbollet e Republikës. Madje edhe Ganja që edhe çorapet e dimrit e mos të flasë të verës i ka kuq e zi, po e sulmon Albinin dhe LV-në për shkak të injorimit të simboleve të Republikës.

Zhvillimi apo takimi i dytë: Hashim Thaçi po i hedh zaret e fundit, jo për ta kaluar Rubikonin, por të mos mbytet në të. Të dielën para protestave të organizuara nga LV-ja fillimisht shkoi në FSK, ku si komandant suprem i forcave të armatosura e bëri mobilizimin e përgjithshëm, duke i vënë në gjendje gatishmëri dhe duke e shpallur një gjendje lufte rezervë. Pastaj, së bashku me Abelardin, skajshmërisht të radikalizuar dhe Bedri Hamzën, të shoqëruar nga shefi i AKI-së, Shpend Maxhuni dhe drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, e morën një kombajnë të ujit të cilin e drejtonte Hashimi, si në kohën e të korrave të grurit! Në sfond dëgjohej dueti Abelard dhe Bedri duke kënduar këngën: "Vijnë vaporat moj nënë, përtej detit..." Hashimi tha se kjo ishte një vizitë krejtësisht transparente, e ligjshme si dhe dëshmi e lëvizjes së lirë... me një duzinë policësh të armatosur, sikur Xhejms Bondi. Më shumë kishte policë në eskortën e Hashimit se që kishte policë që mbikëqyrnin protestën e LV-së. Goran Rakiqi, një pion i Marko Gjuriqit, Ivica Daçiqit, Vojislav Sheshelit dhe Aleksandar Vuçiqit e kërcënoi haptas presidentin Thaçi, ministrin Tahiri dhe Hamzën, edhe krerët e Kosovës për siguri, Maxhunin dhe Qalajn, që po e vizitojnë Ujmanin, pa lejen e Serbisë, sikur që Ujmani të ishte pjesë e Serbisë apo Liqeni i Paliqit afër Suboticës e jo pjesë integrale dhe e patjetërsueshme e Kosovës. Ku janë tani prokurorët e Kosovës që nuk merren me deklaratën kërcënuese të Goran

Rakiqit në ndërkohë që deputetët Zeka dhe Demalijaj po pshurrin në qyp të burgut për kërcënime beninjë krahasuar me këto të Rakiqit?! Pse do të duhej Hashimi apo dikush tjetër të merrte leje nga pizevengët e Serbisë që nuk lanë të zezë pa bërë në Kosovë dhe pse për këtë duhet të merren leje nga KFOR-i apo BE-ja?! Po Hashimi e gjeti një ditë krejtësisht të gabuar për ta vizituar Ujmanin dhe kjo vizitë konsiderohet si përpjekje për ta relativizuar protestën gjithëpopullore të organizuar nga LV-ja. Ky ishte jo gabimi i Thaçit, por përpjekja për manipulim përmes improvizimit në bazë të së cilës e ka marrë, po e mban dhe do të bëjë përpjekje ta mbajë pushtetin edhe në të ardhmen, së paku deri te mesi i vitit 2019, e që nënkupton se lehtësisht mund ta përfundojë mandatin një vit para afatit kushtetues nëse edhe në të ardhmen do të sillet në mënyrë të papërgjegjshme duke konsideruar se shteti (Kosova) jam unë dhe se pas meje vetëm vjen kiameti, disi sikur mbreti Luigj i Francës. Hashim Thaçi duhet të lëshohet në tokë dhe vetëm pasi t'i prejë prapanica në tokën e përgjakur me shekuj të Kosovës, mund të flasë për Kosovën dhe në emër të Kosovës. Nuk mund ta ketë më të afërt Vuçiqin se Albinin e as Daçiqin se komandant Dullën sikur që, në aspektin kombëtar, politik e shtetëror nuk mund ta ketë më të afërt Behgjetin se Behxhetin! Kur t'i kuptoj këto fakte atëherë mund të thjëllet, nëse nuk bëhet vonë! Mbështetja ekskluzivisht te ndërkombëtarët është sikur të mbahesh për degë, mbështetja në popull është sikur të kapeshe pas rrënjëve. Hashimi deri më tani po e bën të kundërtën dhe ka mbetur sikur Don Kishoti me Sanço Pançon (Bekimin) dhe për këtë, domosdoshmërisht po e bën luftën kundër mullinjve të erës. Përpjekjet për ta shantazhuar qeverinë Haradinaj me rrëzimin e saj vetëm sa do ta rrënojnë politikisht. Edhe kjo vizitë kishte publicitet të madh medial. Dhe, Takimi apo zhvillimi i tretë ishte vizita historike e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në fshatin Burojë, ku u takua me Haxhi Thaçin. Ky takim nuk kishte kurrfarë mbulimi mediatik andaj mendoj se këtu janë rrahur tema të rëndësishme së madhe për Kosovën, rajonin dhe botën! Në mungesë të informatave për këtë takim, u lëshova në spekulime, prandaj me aq edhe po e përfundoj këtë shkrim. Zoti e bekoftë Kosovën, Zoti e bekoftë presidentin tonë që aq shumë e duam, sidomos këta që po e kërkohen kokën e tij politike! Dhe, jo vetëm politike!

Erdogani fton Merkelin dhe Steinmeierin në Turqi

STAMBOLL, 1 TETOR - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan tha se kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti Frank Walter Steinmeier do ta vizitonte Turqinë në vitin 2019 me ftesën e tij. "Të dyja palët kanë rënë dakord për ta vizituar njëri-tjetrin më shpesh", u tha Erdogan të shtunën gazetarëve gjatë kthimit në Turqi pas viz-

itës së parë shtetërore në Gjermani. "Vullneti i mirë... ne do t'i presim ata në Turqi në vitin 2019", tha ai, sipas komenteve të publikuara të martën nga e përditshmja turke "Hurriyet". Ai tha se Gjermania është një vend i rëndësishëm për Turqinë, ndonëse problemet mes tyre vazhdojnë dhe kritikoi sjelljen e

Steinmeierit gjatë një banketi ku foli për burgosjen e qytetarëve gjermanë në Turqi dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Ndërkaq, presidenti gjerman Frank Walter Steinmeier do të vizitojë Greqinë javën e ardhshme ku do të takohet me kryeministrin Aleksis Cipras dhe liderin e opozitës, Kiriakos Micotakis.



Marrëveshje e re tregtare ShBA - Kanada

Zyrtarët amerikanë dhe kanadezë kanë njoftuar se kanë arritur një marrëveshje tregtie, duke mundësuar një pakt të modifikuar trepalësh me Meksikën, për ta zëvendësuar marrëveshjen prej gati një çerek shekulli të Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Amerikës Veriore (NAFTA)

UASHINGTON, 1 TETOR - Pas diskutimeve të ngjeshura të minutës së fundit përpara një afati të vetëimponuar që skadonte në mesnatë, zyrtarët amerikanë dhe kanadezë njoftuan të dielën vonë se arritën një marrëveshje tregtie, duke mundësuar një pakt të modifikuar trepalësh me Meksikën, për ta zëvendësuar marrëveshjen prej gati një çerek shekulli të Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Amerikës Veriore (NAFTA).

Marrëveshja ShBA-Meksikë-Kanada (USMCA), që mbështet një tregti vjetore prej 1.2 trilion dollarësh, pritet të nënshkruhet brenda 60 ditësh nga presidenti Donald Trump dhe udhëheqësit kanadez e meksikan. "Ne mendojmë se kjo është një marrëveshje fantastike për Shtetet e Bashkuara", u tha gazetarëve një zyrtar i lartë i administratës në një konferencë të organizuar me nxitim, duke shtuar se ajo është "një fitore e madhe për presidentin".

Presidenti Trump e kishte shndërruar qëndrimin e tij kri-

tik ndaj NAFTA-s në pjesën qendrore të fushatës së tij të zgjedhjeve të vitit 2016. "Marrëveshja më e keqe tregtare mbase e nënshkruar ndonjëherë, por pa dyshim më e keqja e nënshkruar ndonjëherë në këtë vend", kishte thënë ai për NAFTA-n, duke e fajësuar atë për humbjen e vendeve të punës në Amerikë që kur hyri në fuqi në vitin 1994. Kongresi amerikan ka të ngjarë të merret me USMCA-n vitin e ardhshëm. Fati i saj në duart e ligjvënësve amerikanë mbetet i paqartë, veçanërisht nëse demokratët do të marrin kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve në zgjedhjet e nëntorit.

"USMCA do t'u japë punëtorëve tanë, fermerëve dhe bizneseve një marrëveshje të standardit të lartë të tregtisë që do të mundësojë tregje më të lira, tregti më të drejtë dhe rritje të fuqishme ekonomike në rajonin tonë", thanë në një deklaratë të përbashkët Robert Lighthizer, përfaqësues i Shteteve të Bashkuara



dhe ministrja e Jashtme kanadeze, Chrystia Freeland. "Kjo do të forcojë klasën e mesme, do të krijojë vende pune të mira dhe të paguara mirë si dhe mundësi të reja për pothuajse gjysmë miliardë njerëz që e quajnë shtëpinë e tyre Amerikën Veriore", tha Freeland. Marrëveshja do ta rrisë qasjen amerikane në tregun kanadez të prodhimeve të qumështit, me

disa lëshime në sistemin e saj të mbrojtur mire të menaxhimit të furnizimit, duke mbrojtur kanadezët nga tarifatat e mundshme amerikane.

Tarifatat amerikane për çelikon dhe aluminin, megjithatë do të mbeten në fuqi. Kanadaja ka kërkuar mbrojtje nga tarifatat e presidentit Trump për importet e çelikut dhe aluminin. Diskutimet për tarifatat e met-

aleve "janë në binarë të tjerë", sipas një zyrtari të lartë amerikan. Në një fitore të madhe për Kanadanë, sistemi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve i kapitullit të 19-të të NAFTA-s, do të mbetet i paprekur. Duke u larguar nga takimi 75 minutësh i kabinetit të tij të dielën, kryeministri kanadez, Justin Trudeau, tha vetëm se ishte ditë e mirë për Kanadanë.

Vazhdon beteja për emërimin e gjykatësit Brett Kavanaugh

UASHINGTON, 1 TETOR - Beteja për kandidatin e Gjykatës së Lartë, Brett Kavanaugh, vazhdon këtë javë, ndërsa FBI-ja po kryen një hetim të kufizuar të disa akuzave për sjellje të papërshtatshme seksuale kundër tij. Dëshmia e javës së kaluar e kandidatit dhe një pjesë prej akuzuesve të tij nuk ndryshoi asgjë në ndasitë e thella politike në Senat, por e shtyu për një javë votimin për Kavanaugh. Ishte një dëshmi që mbajti të mbërthyer gjithë vendin. "Më shtynë në krevat dhe Brett u hodh mbi mua", tha profesore-

sha Christine Blasey Ford. "Nuk e kam bërë kurrë një gjë të tillë as me të, as me njeri tjetër", tha Kavanaugh.

Komisioni Juridik miratoi kalimin e kandidaturës së gjykatësit Kavanaugh për votim në Senat, me kushtin që FBI-së t'i jepej një javë për t'i hetuar akuzat ndaj tij kur ishte i ri. "Nuk e di nëse do të ndryshojë ndonjë votë për një javë, por njerëzit mund të thonë 'patëm një proces më të mirë'. Dhe kjo na duhet për ta bashkuar vendin", tha senatori republikan Jeff Flake.

Demokratët kishin kërkuar për

një kohë të gjatë një hetim të FBI-së. "Le ta ngadalësojmë ritmin, të kemi më shumë informacion. Të mos vendosim në Gjykatën e Lartë dikë që rrethohet nga mjegulla e këtyre akuzave", tha senatorja demokrate Patty Murray. Presidenti Donald Trump në fillim tregoi durim për vonesat, por më pas sulmoi demokratët. "Ata janë të vendosur ta rimarrin pushtetin me çdo mjet të mundshëm. Mund ta shohësh qartë ligësinë. Atyre nuk u intereson se kë lëndojnë", tha Trumpi.



Ministria e Kulturës mbështet realizimin e librit monografik për Nexhmije Pagarushën

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesin e organizatës "Integra", Kushtrim Koliqi, me të cilin ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi. Qëllimi i nënshkrimit të memorandumit është mbështetja financiare për realizimin e monografisë për këngëtares Nexhmije Pagarusha, e cila ka dhënë kontribut unik jetësor në pasurimin kulturor, social, ekonomik dhe politik të Kosovës. Libri do të vijë si histori e shtrirë në formë romani me qëllimin që publikut t'i prezantohet i gjithë mozaiku jetësor e artistik i Pagarushës. Monografia për Nexhmije Pagarushën do ta përmbledhë të gjithë jetën dhe veprimtarinë e saj prej artisteje. I ndarë në disa kapituj, libri do ta paraqesë rrugën e këngëtares nga fëmijëria deri në ditët e sotme. Vetë këngëtarja me rrëfimin e saj artistik e jetësor do të jetë boshti i rrëfimit të librit

që do të publikohet në konturat e një romani. Me këtë rast, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se është i lumtur për nënshkrimin e këtij memorandumit. "Monografia do të vë në pah rëndësinë e karrierës muzikore të Pagarushës, që përfaqëson një pjesë vitale të trashëgimisë shpirtërore të vendit tonë", ka theksuar ai. Ministri Gashi ka treguar se ky projekt zbatohet në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturor, duke theksuar se libri do të mbetet trashëgimi e institucioneve të vendit dhe brezave të rinj. Ndërkaq organizatori ekzekutiv i organizatës "Integra", Kushtrim Koliqi, ka falënderuar ministrin dhe Departamentin e Trashëgimisë për gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar për realizimin e këtij projekti me rëndësi të madhe në fushën e kulturës e të trashëgimisë. Ai ka shpjeguar se, përveç rrëfimit të këngëtares Pagarusha, si bosht



i rrëfimit të librit, do të zënë vend intervistat me muzikantë të tjerë që kanë punuar në këngët e Pagarushës, që do ta plotësojnë rrëfimin e saj. "Pos këtyre, pjesë e monografisë do të

jenë edhe të gjeturat e hulumtimeve që do të bëhen në arkivat e kohës. Tekstet apo kritikët që u janë bërë veprave të saj, po ashtu do të jenë pjesë e librit. Kështu, libri do të kompletohet edhe me

fotografitë e shkrepura në kohë të ndryshme përgjatë karrierës së Pagarushës, në mënyrë që, pos rrëfimit të saj, periudhat të dokumentohen edhe me pamje", ka deklaruar Koliqi.

Në Köln të Gjermanisë xhirohet filmi më i ri i Visar Morinës



PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Pas sukseseve me filmin "Babai", i cili në Festivalin e Karlovy Varyt fitoi çmimin për regjinë më të mirë, skenaristë dhe regjisorin Visar Morina sjell projektin më të ri kinematografik "Exile", skenari i të cilit është shpërblyer me çmimin pres-

tigjioz gjerman "Lola's Gold". Filmi rrëfen tregimin e Xhaferit, një inxhinier i kimisë me origjinë nga Kosova, i cili ndihet i diskriminuar dhe i ngacmuar në vendin e punës, gjë që e zhytë atë në krizë të identitetit. "Exile" është bashkëprodhim në

mes të Komplizen Film Gjermani, Ikonë Studio Kosovë dhe Frakas nga Belgjika, i financuar nga: Minister of State for Culture and Media, Film und Medienstiftung NRW, German Federal Film Fund, Belgium Film Tax Shelter, Medienboard Berlin Brandenburg,

Qendra Kinematografike e Kosovës, Eurimages, German Federal Film Board. Film "Exile" sjell një kastë brilante të aktorëve sikur Sanrda Huller e njohur për rolin e saj në filmin "Toni Erdmann", Mishel Matičević, ndërsa në film do të

paraqiten aktorët shqiptarë Astrit Kabashi, Valentina Dubovci, Flonja Kodheli, Getuart Hajrizaj, Ameli Kabashi. Xhirimet e filmit përfundojnë në fund të muajit tetor, ndërsa filmi pritet të jetë i gatshëm në mes të vitit të ardhshëm.

Shuhet në moshën 94-vjeçare ikona e muzikës franceze Charles Aznavour

PARIS, 1 TETOR - Charles Aznavour, një prej emrave më të mëdhenj të muzikës botërore, është ndarë nga jeta në moshën

94-vjeçare. Ai mbahet mend si autor i një sërë veprave që kanë shkruar historinë e muzikës. Lajmi është konfirmuar nga të

afërmit e kantautorit. Ai ishte me origjinë armene dhe cilësohej si "monument i muzikës franceze". Me një zë potent,

Aznavour ishte zbuluar si talent nga Edith Piaf. Ai ishte nderuar edhe me tituj të rëndësishëm në Francë.



E rrallë

Kthehen nga muaji i mjalit, shtëpinë dhe veturën e gjetën të mbështjellë me qese najloni

Jenny dhe Jonathan Minger mbetën të hutuar kur u kthyen në Cheshire të Anglisë, për ta gjetur shtëpinë dhe veturën e mbështjellë me qese najloni. Gruaja 25-vjeçare dhe burri saj një vit më i ri, që ishin në muajin e mjalit në Cancun të Meksikës, shfrytëzuan një thikë të vogël që ta hapin derën. Pasi pushuan, të



nesërmen ata u desh të dalin për ta larguar shtresën që e kishin vënë si mahi shokët e tyre.

FOTO E DITES



Një urë u shemb në hyrjen e gjirit në Palu të Indonezisë për shkak të cunamit që mori me qindra jetë. /Reuters/

E jashtëzakonshme

Burri me mjekrën më të gjatë në botë

Një burrë nga India ka deklaruar se ka mjekrën më të gjatë në botë që arrin 6.7 metra. Girdhar Vyas është bërë i njohur në vendin e tij dhe pozon shpesh me fansat vetëm për shkak të mjekrës. Ai ka nisur t'i rrisë mustaqet që prej vitit 1985 dhe është i bindur se askush në botë nuk i ka më të gjata. Në një intervistë për "BTV", Girdhar ka shpjeguar rutinën e përdit-



shme ku kalon nga tri orë duke aplikuar vaj dhe piper në mjekër.

BARSOLETA E DITËS



Djali: Shumë e keqe qenke!

Vajza: Ec more këqyre veten, i pitë dërrasë qenke!

Djali: Po, po, veç mua nesër dehja më kalon.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

Rolet: Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

Regjia: Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00 "THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

Rolet: Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

Regjia: Jennifer Yuh Nelson

Në ora 20:00 dhe 22:00

"THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

Rolet: Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

Regjia: Shane Black



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Punët shkojnë mirë, por disa përplasje kohët e fundit ju kanë vënë përpara një vendimi të prerë. Jeni të sigurt për hapin që po ndërmerrni.



DEMI

Xhelozia sot do ta shoqërojë raportin në çift. Një situatë jo dhe shumë e qartë do t'i lëkund ekuilibrat që kishit vendosur me njëri-tjetrin.



BINJAKËT

Ditë e vështirë sa iu përket ndjenjave dhe pasionit. Shumë dyshime do të lindin nga hiçi dhe humori juaj do të jetë me ulje ngritje të mëdha.



GAFORRJA

Sot jeni të ndjeshëm dhe intuita do t'ju sugjerojë të gjendeni pranë miqve që kanë më tepër nevojë për ju në këto çaste.



LUANI

Ana sentimentale lë shumë për të dëshiruar sot dhe ju vetë nuk po investoni sa duhet. Çdo vëmendje tuajën e ka përfshirë puna.



VIRGJËRËSHA

Dita është mjaft premtuese për ju dhe projektet që keni marrë përsipër. Çdo gjë po shkon sipas planeve dhe nuk do të mungojë humori.



PESHORJA

Instinkti juaj nuk gabon sot dhe do të shikoni që mjaft situata që po zhvillohen ju i kishit menduar më parë. Ju ka humbur besimi te njerëzit.



AKREPI

Ju dhuron dashuri pa kushte dhe kjo gjë ju pëlqen. Megjithatë jeni zhgënjyer nga një person, do të përpiqeni ta rikuperoni raportin.



SHIGJETARI

Jeni shumë mirë me financat sot dhe kjo ju ka sjellë mjaft qetësi shpirtërore, gjë që nuk mund të thuhet për dashurinë që ju mundon gjithmonë.



BRICJAPI

Sot mjafton të lini pas krahëve të kaluarën tuaj dhe brejtjen e ndërgjegjes dhe gjërat do të jenë më të qarta dhe më të thjeshta.




UJORI

Këtë periudhë jeni ju armiq të më të këqij të financave tuaja. Po harxhoni pa fund dhe duket se kjo gjë po ju pëlqen.



PESHQIT

Sot jeni të qetë me gjithë vullin e madh që ka dita. Keni mundur të vini përpara punët e papitura që ju kanë dalë dhe tashme shijoni çastin.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

CSKA MOSCOW - REAL MADRID

2

MAN UTD - VALENCIA

1

AEK ATHENS - BENFICA

2

Priten medalje nga Buenos Aires

Ekspedita e Kosovës ka udhëtuar të hënën pasdite drejt Argjentinës për të marrë pjesë në Lojërat Olimpikë verore. Në këto lojëra synohet të arrihen rezultate pozitive, pse jo edhe medalje. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shprehur besimin se pas Rios, flamuri i Kosovës do të ngrihet edhe në Buenos Aires. "Pas Rios, mbetemi me shpresë se flamuri i Kosovës do të ngrihet lart edhe në Buenos Aires", ka thënë Hashim Thaçi

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 TETOR - Kosova merr pjesë në Lojërat Olimpikë për të Rinj (LOR), Buenos Aires 2018 me pesë sportistë. Në këto lojëra ekipi olimpik i Kosovës synon të marrë medalje për faktin se sportistët në fjalë kanë cilësi për të dalë me rezultate pozitive në garën që Kosova merr pjesë për herë të parë. Sportistët që e prezantojnë Kosovën në Lojërat Olimpikë janë Erza Muminoviq (xhudo), kategoria -44 kilogramë, Erdonis Maliqi (boks), kategoria 64 kg, Muhamet Ramadani (atletikë) disiplina: hedhje e gjyles 5 kg, Melisa Zhdrella (not) disiplina: 50 metra krol dhe Bleron Fetaovski (peshëngritje), kategoria deri 77 kg. Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka thënë para nisjes së ekipit olimpik drejt Buenos Airesit, se në këto lojëra synohet medalje historike për

Kosovën. "Kosova merr pjesë për herë të parë dhe kjo pjesëmarrje është historike. Erza është përgatitur fizikisht dhe psikikisht për ta nderuar vetën dhe Kosovën në këtë garë unike. Ajo do të dëshmojë se Majlinda Kelmendi ka pasardhëse. Notuesja Zhdrella është optimiste se në Buenos Aires do ta thyjë rekordin e saj personal dhe nëse ia del këtij synimi do t'i realizojë pritshmëritë tona. Fetovski prezanton peshëngritjen, një sport i themeluar pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe ai është optimist se do të marrë rezultate pozitive. Boksi prezantohet me Maliqin, një talent i ri dhe me perspektivë. Ekspertët e boksit presin që boksi do t'ia rikthejë shkëlqimin e dikurshëm me gjen-eratën e re në gjashtë vjetët e ardhshme Atleti Ramadani me performacën në ngritje nga dita në ditë konfirmon se atletika do të jetë një sport që do të marrë pjesë nëpër Lojëra Olimpikë duke e fitu-



ar normën dhe jo vetëm me ftesa", ka thënë Hasani, i cili ndihet i kënaqur se nga pesë sportistët janë dytë gjinisë femërore. Ekipit Olimpik i ka dhënë mbështetje edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi. "Është e rëndësishmja pjesëmarrja e këtyre pesë sportistëve të Kosovës për herë të parë në garat që zhvillohen në Argjentinë. Përfaqësimi i Kosovës si shtet nga ambasadorët e vet ka rëndësi të madhe dhe ne e përgëzojmë Komitetin Olimpik për punën e mirë që po bën. Uroj të kthehen me medalje ashtu sikurse kthehen edhe nga garat apo lojërat e tjerë. Ministria e Sportit do të jetë në vazhdimësi në mbështetje të sportistëve", ka thënë Gashi.

Trajneri i Xhudos, Driton Kuka, beson se xhudistja Erza Muminoviq mund të fitojë medalje në Lojëra Olimpikë për të rinj. "Kosova për herë të parë në Lojëra Olimpikë për të rinj. Edhe atje kemi normë olimpikë. Xhudistja jonë e re, Erza Muminoviq, sivjet është bërë kampione evropiane për të rinj. Ajo në Argjentinë shkon me asistent trajnerin Fatos Tabaku. Shpresoj të na bëni krenarë sikur gjithmonë deri tash. Në Lojëra Olimpikë Kosova do të përfaqësohet edhe nga sportistët tjerë, të cilëve, sikur Erzës, ju uroj suksese e prezantim dinjitoz të shtetit tonë", ka shkruar Kukan në "Facebook". "Në Lojërat e para Olimpikë fituam medalje. Në Lojërat Evropiane të para fituam medalje. Në Lojërat e para Mesdhetare fituam katër medalje.

Xhudo të gjitha këto i fitoi për shtetin tonë. Aspak s'ka lidhje që s'po na ndërtoni qendrën nacionale. Ne s'do të ndalemi kurrë. Dhashë Zoti të kemi pak fat e do të kemi medalje edhe nga Argjentina e largët", ka shkruar Kuka.

Presidenti Thaçi pret paraqitje dinjitoze të sportistëve në Buenos Aires

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka uruar sportistët e Kosovës, Erza Muminoviqin, Melisa Zhdrellan, Muhamet Ramadani, Erdonis Maliqin dhe Bleron Fetaovskin, për paraqitje të mirë në Lojërat Olimpikë Verore në Buenos Aires. "Ambasadorët më të mirë të republikës sonë, sportistët tanë, sonte nisen për në Argjentinë, ku do të garojnë në Lojërat Olimpikë Verore për të rinj, Buenos Aires 2018. I uroj suksese xhudistes sonë Erza Muminoviqi, notares Melisa Zhdrella, atletit Muhamet Ramadani, boksierit Erdonis Maliqi, peshëngritësit Bleron Fetaovski, si dhe të gjithë pjesëtarëve të ekspeditës kosovare në kryeqytetin argjentinas. Pas Rios, mbetemi me shpresë që flamuri i Kosovës do të ngrihet lart edhe në Buenos Aires", ka shkruar Thaçi në "Facebook".

Kosova, veç me dy klube në Evropë

EPOKA E RE

Liridon ZEQRIRI

PRISHTINË, 1 TETOR - Futboli i Kosovës do të prezantohet në edicionin e ardhshëm me vetëm dy klube në garat evropiane. Këtë lajm ia ka konfirmuar të hënën UEFA, Federatës së Futbollit të Kosovës. Në fakt, ishte pritur që Kosova të ketë tri skuadra në edicionin e ardhshëm në Evropë, pasi Drita dhe Prishtina patën paraqitje të mira. "Shtëpia Evropiane e Futbollit (UEFA) ia ka komunikuar edhe zyrtarisht Federatës së Futbollit të Kosovës që edhe në edicionin pasues të garave evropiane

2019-2020, në garat e UEFA-s, do të marrin pjesë dy klube nga Kosova. Në këtë rast kampioni në rrethin parakualifikues të Ligës së Kampionëve, kurse fituesi i Kupës ashtu si deri tani do të marrë pjesë në rrethin parakualifikues të Evropa Ligës", thuhet në njoftimin e FFK-së. Më pas shtëpia e futbollit e Kosovës ka njoftuar edhe për faktin pse Kosovës nuk i është shtuar edhe një skuadër për pjesëmarrje në garat më të forta ndërkombëtare të futbollit. "Cikli i prezantimit të klubeve në garat e UEFA-s ndryshon çdo tre vjet prandaj, pavarësisht prej rezultateve pozitive të klubeve të



Kosovës në kampanjën e fundit të ndeshjeve në garat e UEFA-s dhe

kërkesës së FFK-së për shtimin e të paktën një klubi në garat ndërkom-

bëtare, ai ndryshim nuk ka reflektuar menjëherë, por efektet mund të ndodhin në vitet në vijim. Të shpresojmë se një gjë e tillë do të ndodhë, por kjo varet shumë nga paraqitja e skuadrave të Kosovës në këto dy gara prestigjioze", ka përfunduar njoftimi i FFK-së. Në edicionin e fundit Drita si kampione dhe Prishtina si fituese e Kupës u paraqiten në Ligën e Kampionëve dhe Evropa Ligë, kurse një vit më herët Kosovën e prezantuan kampionia, Trepça '89 dhe Prishtina. Kjo e fundit ishte nënkampione dhe e fitoi të drejtën, pasi Besa si fituese e Kupës nuk ishte licencuar.

Sot zhvillohet ndeshja Ferizaj - Drenica

PRISHTINË, 1 TETOR - Xhironja e tetë e PKO Superligës do të zhvillohet në mesjavë. Ndeshja e parë zhvillohet sot (e martë) në mes të Ferizajt dhe Drenicës, e cila fillon

në orën 15:30. Ferizaj nuk po arrin rezultate pozitive dhe në këtë ndeshje synim do ta ketë fitoren, kurse në anën tjetër kuqezinjtë nga Skenderaj nuk do

të udhëtojnë me flamur të bardhë. Katër ndeshje zhvillohen të mërkurën, në mesin e të cilave edhe derbi në mes të Llapit dhe Feronikelit. Në ndeshjet e tjera

takohen: Drita-Trepça '89, Liria-Prishtina dhe KEK-u-Ballkani. Të enjten zhvillohet ndeshja e fundit për këtë xhiro në mes të Flamurtarit dhe Gjilanit.



Tifozët e Vëllaznimit kërkojnë rikthimin e Egzon Gashit

GJAKOVË, 1 TETOR - Tifozët e skuadrës së Vëllaznimit nga Gjakova po kërkojnë rikthimin e sulmuesit Egzon Gashi, i cili është larguar nga kjo skuadër

gjatë verës dhe ende vazhdon të jetë lojtar i lirë. "Ende është i pakuptueshëm largimi i sulmuesit Egzon Gashi nga Vëllaznimi dhe po vërehet mungesa e një

qendërsulmuesi. Gashi ishte ndër më meritoret që Vëllaznimi u rikthye në Superligë sezonin e kaluar, ku kishte kontribuar me 230 gola", thuhet në reagimin e

tifozëve kuqezi. Skuadra e Vëllaznimit aktualisht pozicionohet e treta në Ligën e Parë të Kosovës në futboll me 12 pikë të grumbulluara.



Unitedi pret Valencian, Reali i shkon CSKA-s



MANCHESTER, 1 TETOR - Pas një mungese dyjavore, rikthehet Liga e Kampionëve. Në ndryshim nga takimet e para të grupeve, kuadri i përgjithshëm i kësaj jave të dytë është më pak interesant, duke qenë se përballjet janë më të lehta në letër sa iu përket ekipeve të mëdha. Ditën e martë do të zbresin në fushë skuadrat e Grupit E, F, G dhe H. Dy ndeshje do të zhvillohen, sipas tashmë ndryshimeve të këtij edicioni sa i përket orarit, në orën 18:55. Bëhet fjalë për Hoffenheim-Manchester City dhe Juventus-Young Boys. Skuadra e Guardiolës, pas hapit fals në Angli përballë Lyonit, kërkon tri pikët e para në grup, ndërsa nuk lejohen gabime të tjera. Në anën tjetër, në Torino Juventus do të zbresë në fushë pa Cristiano Ronaldon, i shkualifikuar për episodin në "Mestalla" ku me Valencian u ndëshkua me të kuq. Përballë kampionëve në fuqi të Zvicrës, Young Boys, do të jetë sërish radha e Mario Mandzukicit, që po kalon

moment fantastik, teksa duhet parë edhe gjendja e Paulo Dybalas, që ndaj Napolit mori një goditje në kavigj. Do të vazhdojë të jetë jashtë fushës edhe Douglas Costa. Bardhezinjtë duan një tjetër fitore për ta konsoliduar kreun e grupit. Në po të njëjtin grup, në fushë do të zbresë edhe Manchester Unitedi, që vjen nga një situatë e tensionuar, mes tonëve të larta, polemikave, stolit të lëkundur të Mourinhos dhe luftës së hapur mes tij dhe Pogbas. Unitedi do të presë në "Old Trafford" Valencia që humbi me Juven në sfidën e parë. Në Grupin G, Roma duhet të kthehet te sukseset pas humbjes me Real Madridin. Përballë do ta ketë surprizën e madhe Viktoria Plzen. Ndërsa, galaktikët do të udhëtojnë në Moskë, përballë CSKA-s. Në Grupin E, Bayern Muncheni do të ketë të bëjë me Ajaxin, që kryeson grupin, pasi fitoi takimin e parë ndaj AEK-ut 3-0. Në Greqi, sakaq, skuadra e Selanikut pret Benficën. Të dyja me zero pikë

GRUPI E		
21:00 AEK Athens - Benfica		
21:00 Bayern M. - Ajax		
Tabela		
		PIKË
1. Ajax	1	3
2. Bayern M.	1	3
3. Benfica	1	0
4. AEK A.	1	0
GRUPI F		
18:55 Hoffenheim - Man. City		
21:00 Lyon - Shakhtar Donetsk		
Tabela		
		PIKË
1. Lyon	1	3
2. Hoffenheim	1	1
3. Shakhtar D.	1	1
4. Manchester C.	1	0
GRUPI G		
21:00 CSKA Moscow - Real Madrid		
21:00 Roma - Viktoria Plzen		
Tabela		
		PIKË
1. Real Madrid	1	3
2. CSKA M.	1	1
3. Viktoria P.	1	1
4. Roma	1	0
GRUPI H		
18:55 Juventus - Young Boys		
21:00 Manchester United - Valencia		
Tabela		
		PIKË
1. Man. United	1	3
2. Juventus	1	3
3. Valencia	1	0
4. Young Boys	1	0

dhe do të duan t'i marrin pikët e para.

SHKURT

Në janar dihet e ardhmja e Moratas

Alvaro Morata mund të largohet nga Chelsea në merkaton e janarit. Kjo është ajo çka shkruajnë mediet britanike, sipas të cilave, blutë e Londrës janë duke marrë në konsideratë shitjen e sulmuesit spanjoll, i cili në nisjen e këtij sezoni nuk ka gjetur shumë hapësira në formacionin e Sarrit. Aktualisht Morata është zgjedhje e dytë e sulmit pasi trajneri Maurizio Sarri ka preferuar Olivier Giroud në repartin e avancuar. Në rast të një oferte të kënaqshme në merkaton e janarit, rrugët mes Chelseas dhe Moratas mund të ndahen.

Boatengu: Nuk luhet kundër ekipit të zezrës

Te Milani arriti kulmin e karrierës së tij, por për Kevin Princ Boateng rezultoi më e vështirë sesa mendonte përballja me ish-ekipin. Teksa analizozi disfatën e skuadrës së tij, ganezi deklaroi: "Përpos gabimeve tona, Milani duhet të fitonte dhe ia arriti qëllimit. Ata zhvilluan një ndeshje të përsosur dhe këtë e vërteton rezultati. Ishte një takim shumë emocionues për mua, nuk e pata të lehtë të luaja kundër ekipit të zezrës".

Presidenti i Genoas: Çmenduri nëse e shesim Piatekun

Presidenti i Genoas, Enrico Preziosi, ka refuzuar në mënyrë kategorike shitjen e lojtarit, Krzysztof Piatek, i cili ka një kontratë deri në vitin 2022 me klubin italian. Sulmuesi Piatek ka shënuar 12 gola për skuadrën e Genoas në këtë edicion. "Vetëm ta mendosh shitjen e Piatekut është një çmenduri. Unë jam shumë i lumtur me të. E dinim që kishte cilësi të mëdha, është një talent i lindur, por nuk do të tregojta të vërtetën, nëse do të thosha që 'e dija se do të shënonte kaq gola'. Megjithatë, mund të them se ne nuk nënshkruam kontratë me të. E kam parë të luajë dhe ai është një sulmues, i cili shënoi 21 gola në kampionatin polak në sezonin e kaluar, në të gjitha llojet e mënyrave", ka thënë presidenti i Genoas, Krzysztof Piatek.

Pochettino: Nuk do të bëhem trajner i Barcelonës

Trajneri i Tottenham Hotspur, Mauricio Pochettino, ka thënë se ai nuk mund ta marrë drejtimin e Barcelonës. "Tashmë është e ditur. Kam shumë shokë atje, si ashtu në ekipin e Barçës, por mënyra se si shkojmë, është një hap ndryshe, andaj nuk do të ndodhë ajo gjë. Është një ndjenjë e mirë të jetosh në Barcelonë dhe të punosh atje, por është motivuese edhe të përballësh me ta", ka thënë Pochettino.

Sanchezi mund të largohet nga Unitedi

E ardhmja e Alexis Sanchezit duket se do të jetë larg "Old Trafford". Në mediet britanike po flitet shumë për mundësinë e shitjes së sulmuesit kilian nga ana e Manchester Unitedit. Mësohet se trajneri i "Djajve të Kuq" e ka humbur besimin ndaj Sanchezit dhe në ndeshjen e fundit në kampionat me West Ham që Manchester Unitedi e humbi 3-1 ai e la atë jashtë skuadre. Alexis Sanchez u transferua nga Arsenali te Manchester Unitedi në muajin janar dhe është futbollisti më i paguar i Djajve të Kuq me 500 mijë paund në javë, pagë të cilën kiliani nuk e ka justifikuar deri tani, pasi në 23 ndeshje të zhvilluara me fanellën e Manchester Unitedin ai ka shënuar vetëm 3 gola. Por jo vetëm kaq, mësohet se trajneri Mourinho ka pasur një përplasje me futbollistin në një nga seancat stërvitore pasi e kritikoi para pjesës tjetër të skuadrës për paraqitjet e tij të dobëta. Problem tjetër për Sanchezin që mund ta shtyjë atë të largohet nga "Old Trafford" është fakti se Manchester Unitedi ka shumë opsione në repartin e sulmit. Me Lukakun, Rashordin dhe Martialin në ekip, për Sanchezin bëhet shumë e vështirë të fitojë një vend titullari në skuadër.

Maradona, Messit: Largohu nga Kombëtarja

BUENOS AIRES, 1 TETOR - Diego Armando Maradona, që është në javët e para të tij si trajner i Dorados, por ai ndjek me vëmendje dhe atë që po ndodh në përfaqësuesen e Argjentinës. Në muajin tetor skuadra "Albiceleste" do të luajë dy miqësore, njëra prej të cilave është ajo me Brazilin dhe në të dyja këto dy përballje nuk do të jetë kapiteni Lionel Messi që mungoi edhe në miqësoret e muajit shtator. El pibe De Oro foli për sulmuesin e Barcelonës, duke e shfaqësuar edhe një herë për dështimin e Argjentinës në Botërorin e Rusisë. "Do të doja që Messi pas Kupës së Botës të fliste dhe t'i dërgonte të gjithë në ferr. Nuk është faji tij se nuk fituam, edhe pse i gjithë presioni ishte mbi të. E këshilloj ta lërë njëherë e mirë kombëtaren



sepse nëse Argjentina humbet, është faji i tij. Për çdo gjë negative që ndodh në futbollin argjentinas, fajtor është Messi. Dua të shoh se kë do të ngarkojnë me përgjegjësi kur të mos jetë ai te Argjentina", ka thënë Maradona. Argjentina për momentin drejtohet nga Lionel Scaloni, por bardhekalterve u duhet të gjejnë një trajner dhe Maradona e ka preferencën e tij. "Do të doja ta shihja

Menottin si trajnerin e Argjentinës. Edhe unë do të kthehesha të punoja me të me të gjitha ekipet kombëtare. Emra si Simeone, Pochettino e Gallardo nuk do të prezantojnë një projekt të cilin e dinë që Federata nuk do ta respektojë, nuk duan të rrezikojnë atë çfarë kanë arritur në Evropë dhe nuk flas për paratë, por për lavdinë", ka deklaruar Maradona.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
QENDRA KYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
MAIN FAMILY MEDICAL CENTRE
"DR. SHPËTIM ROBAJ"
MALISHEVË
Nr. 484
Data: 01.10.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL - MALISHEVË
QKMF "DR. SHPËTIM ROBAJ" në Malishevë
Nr. Prot. 484/18
Datë 01.10.2018

Drejtori i QKMF-së "Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë, në bazë të Rekomandimit nr.07/145 dt.01.10.2018 të drejtorit të Shëndetësisë dhe MS në Malishevë, nenit 8 të ligjit të punës nr.03/L-212 si dhe nenit 4 të udhimit administrative nr.7/2017, për rregullimin e procedurave për konkurs në sektorin publik; për plotsimin e vendeve të punës publikon këtë:

KONKURS

Për pranimit të:

I. 2. (dy) Mjek të praksës së përgjithshme në kohë të pacaktuar:

Detyrat e punës:
Ofron shërbime shëndetësore nga kujdesi primar shëndetësor në QKMF, QMF dhe AMF.
Siguron kujdes primar shëndetësor për të gjithë qytetaret pa dallim: kombi, etnie, feje, race, Gjinie.
Shkruan terapin, në bazë të diagnostifikimit, udhëzon pacientët në qendra tjera spitalore, kryen të gjitha punët tjera të mjekut familjar në bazë të ligjit të shëndetësisë.
bashkëpunon me mjekë tjerë, për punën e vetë i përgjigjet shefit të mjekësisë familjare, dhe drejtorit të QKMF-së.

Kushtet e konkursit:

- Diploma e fakultetit të mjekësisë drejtimi i përgjithshëm,
- Licencën e punës,
- Certifikatën e lindjes,
- Certifikatën që nuk është nënë hetime ose i denuar.
- Certifikatën e mjekut për punë.
- Leternjoftimin e fotokopjuar.

-Kohëzgjatja kontratës: në kohë të pacaktuar (pas përiudhës provuese tremujore).
-Orët javore të punës 40.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjete të informimit, aplikacionet e arritura pas afatit nuk pranohen, aplikacionet me dokumenta të pa kompletuara nuk shqyrtohen. dokumentacioni dorëzohet në zyrën e personelit të QKMF-së.

Drejtori
Dr. Nuhi Morina - sp. Pedjater

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave / Ministarstvo Finansija / Ministry of Finance
Thesari i Kosovës / Trezor Kosova / Treasury of Kosovo

Shpallje e Ankandit të Letrave me Vlerë KV017-18

Afati dhe Lloji	6 Muaj - Bono Thesari
Shuma e Ofruar	€25,000,000
Kodi i Instrumentit	KV1112921293
Data e Ankandit	09.10.2018
Data e Shlyerjes	10.10.2018
Data e Maturimit	10.04.2019
Mekanismi i Çmimit	Çmime të Shumëfishta

Shënim: Qeveria e Republikës së Kosovës rezervon të drejtën për ri-blejë të kësaj Letre me Vlerë nëpërmjet operacioneve të përcaktuara në Rregulloren për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

Announcement of Securities Auction KV017-18

Term and Type	6 Months - Treasury Bill
Offering Amount	€25,000,000
Instrument Code	KV1112921293
Auction Date	09.10.2018
Settlement Date	10.10.2018
Maturity Date	10.04.2019
Pricing Mechanism	Multiple Price

Note: The Government of the Republic of Kosovo reserves the right to re-purchase this Issue through operations defined in the Regulation for Primary and Secondary Market of Government Securities.

Objava Aukcije Hartija od Vrednosti KV017-18

Rok i Tip	6 Meseci - Bono Trezora
